- Me Vendimin e Gjyqtarit të Vetëm Nr.12730/8, Dt.19.04.2005 është bërë depozitimi i Vendimit Nr.1, datë 18.03.2005 të Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme të shoqërisë Fufarma Sh.A
- Me Vendimin e Gjyqtarit të Vetëm Nr.12730/9, Dt.16.06.2005 është bërë depozitimi i Vendimit Nr.4, datë 04.06.2005 të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë Fufarma Sh.A
- Me Vendimin e Gjyqtarit të Vetëm Nr.12730/10, Dt.19.06.2006 është bërë depozitimi i Vendimit Nr.1, datë 03.05.2006 të Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve të shoqërisë Fufarma sh.a. dhe të Vendimit Nr.2, datë 06.05.2006 të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë

2. - - Me Vendimin Nr.2, datë 04.04.2007, Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë Fufarma Sh.A., ka vendosur:

1. 1). Të pranohet dorëheqja e Z.Agron SHEHAJ.
2. Drejtor i shoqërisë emërohet Z.Doni BERBERI.
3. Paga e Drejtorit të jetë 70.000 (shtatëdhjetë mijë) Leke.
4. T'i komunikohen ndryshimet e lartpërmendura bankave me të cilat kemi marrëdhënie. Në këto të fundit si dhe në ato me të cilat do të kontaktojmë në të ardhmen, të depozitohet si firmë e parë Z.Doni BERBERI. Në momentin e depozitimeve të lartpërmendura, depozitimet e mëparshme bëhen të pavlefshme përsa i përket firmës së parë.

3.- Kërkohet depozitimi pranë Regjistrat Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i Vendimit Nr.2, datë 04.04.2007 të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë

Kërkesa është e drejtë dhe në bazë të ligjit duhet pranuar.


PËR KËTË ARSYE

Në bazë të Ligjit Nr.7632, Dt.04.11.1992, Ligjit Nr.7638, Dt.19.11.1992 dhe të Ligjit
7667 datë 28.01.1993, nenet 2, 24, 33,

V E N D O S A

- 1.- Pranimin e kërkesës.
- 2.- Depozitimin e Vendimit Nr.2, datë 04.04.2007 të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë
- 3.- Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse në Regjistrin Tregtar.
- 4- Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar t'ju komunikojë vendimin subjekteve të interesuara.

GJYQTARË



URDHER REGJISTRIMI

Me

1.

2.a. F.U. - Farme Tihane S.A.b. Tihanec. Prumbullim artikujsh
forma centikd. 232380.000 lekë (me natyrë)3. P. Carag
J. Zepo
J. Samour } Antetë të k/pulës/kyres4. Statuti nënshkruar me datë 12.5.19955. Data 06.5.1995

Statuti 10 Flete

Njoftime: a. shoqëria

b. dhomen e tregtisë

c. organit perkates financiar

d. zyres se statistikes

Publikime: X

GJYQTARE

(4 Paga)
704

AKT-THEMELIMI

I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 17.10.1995, Ministria e Financave, ne baze te Ligjit Nr.7926, date 20.4.1995, vendosi :

1. Te krijoj shoqerine anonime si pasoje e transformimit te ndermarrjes Fytnizim Artikuj Farmaceutik Tirane.
2. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete, grumbullim, tregtim artikuj farmaceutik.
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne qytetin e Tiranes.
4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 232.380.000 leke, i ndare ne 232.380 aksione, me vlere nominale 1.000 leke.
5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :
 1. Petraq Cama
 2. Ilir Zeqo
 3. Ilia Samsuri
7. Ndertimi organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themelues.

DREJTORI I DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE



STATUT

I

SHOQERISE ANONIME

Ne baze te dispozitave te ligjit Nr.7926, date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", me autorizim te Ministrit te Financave Z.Berzh Piranian, Drejtor i Drejtorise te Shoqerive Publike nenshkruan statutin e shoqerise anonime si me poshte :

Neni 1

Shoqeria anonime formohet nga transformimi i ish-ndermarrjes shteterore Furnizim Artikuj Farmaceutik Tirane.

Shoqeria e krijuar ne kete menyre emerohet SH.A "Furnizim Artikuj Farmaceutik" ose shkurt "FU-FARMA" Tirane.

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranes.

Neni 2

Objekti i shoqerise eshte ; grumbullim, tregtim artikuj farmaceutik.

Shoqeria, brenda cageve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryje cdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejteperdrejte ose terethore me objektin e saj. Kjo perfshin gjithshu hapjen e veprimtarive te reja, krijimin e sipermarrjeve te tjera dhe pjesmarrjen ne sipermarrje te tjera si brenda, ashtu edhe jashte vendit pa cenuar objektin e shoqerise.

Neni 3

KAPITALI THEMELTAR-AKSIONET

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 232.380.000 leke. Ai eshte i ndare ne 232.380 aksione te se njejtes kategori, te cilat zoterohen teresisht nga shteti.

Vlera nominale e aksionit eshte 1.000 leke.

Ne shumen e kapitalit te shoqerise nuk eshte perfshire vlere e truallit, gje qe do te behet ne nje kohe te dyte perpara se shoqeria te privatizohet ose ne momentin e privatizimit.



Neni 4

SHITJA E AKSIONEVE NE RASTIN E PRIVATIZIMIT

Aksionet e shoqerise mund t'u shiten personave fizike e juridike shqiptare vetem ne rastin e nje vendimi te marre nga Ministri i Financave per privatizimin e shoqerise nepermjet bonove te privatizimit dhe/ose lekeve te privatizimit

Personat e huaj, fizike e juridike, mund te blejne aksione te shoqerise vetem ne rastet dhe ne masen e caktuar nga Ministri i Financave. Shlyerja e aksioneve nga personat e huaj, fizike e juridike, behet vetem me para ose me anen e kontributeve ne natyre per qellime teknologjike.

Ky nen nuk zbatohet per shoqerite qe veprojnene sektoret e naftes, minierave dhe energjise elektrike, aksionet e te cilave shiten sipas legjislacionit perkates te privatizimit te seciles prej tyre.

Neni 5

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1. Keshilli mbikqyres
2. Drejtori i pergjithshem

Neni 6

KESHILLI MBIKQYRES

1. Keshilli mbikqyres perbehet 3 anetare.
Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen :

2/3 nga Ministri i Financave

1/3 nga Ministri i Shendetesise dhe Mbrojtjes se Mjedisit.

II. Kohezgjatja e fuksionit te tyre eshte 4 vjet. Anetaret e Keshillit mbikqyres jane te gjithe te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga titullari i organit qe i ka emeruar vetem per shkage te perligjura.

III. Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.



IV. Ne se nje ose disa vende te anetareve te keshillit te mbikqyrjes mbeten bosh per shkak vdekjeje, shkarkimi ose doreheqje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se tre muaj.

Anetari i keshillit mbikqyres, i emeruar me zevendesim te nje anetari tjeter, perfundon mandatin e paraardhesit.

V. Anetaret e keshillit mbikqyres nuk mund te bejne pjese ne me shume se tre keshilla mbikqyres te shoqerive anonime qe e kane seline ne territorin e Republikes se Shqiperise.

VI. Anetaret e keshillit mbikqyres te moshes mbi 65 vjeç nuk mund te jene me shume se nje e treta e numrit te pergjithshem ne mbyllje te ushtrimit te çdo viti financiar. Nese kjo perqindje tejkalohet anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

VII. Ky keshill do te funksionojë deri ne momentin e shitjes se aksioneve. Pastaj shoqeria do funksionojë ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 7

KRYETARI DHE ZEVENDESKRYETARI I KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendeskryetar te cilet ngarkohen te mbledhin keshillin dhe te drejtojnë diskutimet. Ata emerohen per te gjithë kohen e mandatit te tyre ne keshillin mbikqyres dhe jane te rizgjedhshem.

Keshilli mbikqyres mund te emerojë nje sekretar jashte anetareve te tij.

Neni 8

VENDIMET E KESHILLIT

Keshilli mbikqyres mblidhet sa here qe e kerkon interesi i shoqerise, me thirrjen e kryetarit, ose ne mungese te tij, te zevendeskryetarit.

Kryetari duhet te therrase keshillin mbikqyres, brenda pesembedhjetë diteve, kur drejtori ose nje e treta e anetareve te keshillit mbikqyres i paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete gellim.

Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere autoret e saj mund te therrasin keshillin, duke i permendur rendin e dites.

Ne parim thirrja duhet te behet tre dite perpara, me leter, telegram, teleks ose telefaks. Por ajo mund te behet me goje dhe pa afat ne qofte se anetaret e keshillit mbikqyres e pranojne ate.

Çdo thirrje duhet te tregojë çeshtjet kryesore te rendit te dites.

Mbledhja e keshillit mbikqyres behet ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te treguar ne thirrje.

II. Keshilli mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem, ne qofte se jane te pranishme jo me pak se gjysma e anetareve te keshillit.

Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem. Ne rast votash te barabarta, ajo e kryetarit eshte percaktuese.

III. Keshilli mbikqyres mban nje regjister te pjesmarrjes ne mbledhjen e tij, i cili nenshkruhet nga anetaret e pranishem ne mbledhje.

IV. Vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen me procesverbale te hartuara ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, nga kryetari i seances dhe nga nje anetar i keshillit ose, ne mungese te kryetarit, nga jo me pak se dy anetare te keshillit.

Kopjet e ketyre procesverbaleve vertetohen nga kryetari keshillit mbikqyres, zevendes kryetari dhe nga drejtori i pergjithshem.

Neni 9

KOMPETENCAT E KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga drejtori i pergjithshem i saj dhe i jep ketij te fundit autorizimin paraprak per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtori i pergjithshem pa autorizimin paraprak te keshillit mbikqyres.

Keshilli mbikqyres emeron drejtorin e pergjithshem.

Ai autorizon marreveshjet e parashikuara ne nenin 13 te ketij statuti.

Ai autorizon drejtorin e pergjithshem te kryeje veprimet dhe te marre masat e parashikuara ne nenin 12 te jetij statuti.



Keshilli mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontrole qe ai i çmon te pershtatshme, dhe kerkon te njihet me dokumentet qe ai i gjykon te nevojshme per permbushjen e dyteres se tij.

Drejtori i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj.

Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar, drejtori duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore me gellim verifikimi dhe kontrolli tyre nga ky i fundit.

Keshilli mbikqyres miraton llogarite vjetore dhe raportin vjetor te paraqitur nga drejtori i pergjithshem.

Keshilli mbikqyres mund t'i ngarkoje njerit ose disa anetareve te tij çdo mandat te posaçem per nje ose disa objekte te caktuara.

Neni 10

SHPERBLIMI I ANETAREVE TE KESHILLIT MBIKQYRES

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.348 date 3.7.1995 "Per keshillat mbikqyres te shogerive shteterore".

Neni 11

DREJTORI I PERGJITHSHEM

1. Drejtori i pergjithshem emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakord jo me pas se 3/4 e anetareve te ketij keshilli. Ai mund te zgjidhet qofte ndermjet personave te shoqerise, qofte edhe jashte te punesuarve te saj.

Nese nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet drejtor mandati i tij ne keshill merr fund me hyrjen e tij ne funksion.

Nje person nuk mund te emerohet drejtor ne me shume se nje shoqeri.

Drejtori mund te shkarkohet nga keshilli mbikqyres vetem per shkaqe te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur nje kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga funksioni i drejtorit nuk eshte shkak per zgjidhjen e kesaj kontrate.

II. Drejtori emerohet per nje periudhe kohe prej 4 vjetesh. Ne rastet te pushimeve dhe te mungesave te tjera te zgjatura, keshilli mbikqyres ben menjehere zevendesimin e tij.



Drejtori eshte i riemerueshem. Ai nuk mund te jete ne moshen mbi 65 vjeç.

Drejtori qe mbush 65, quhet zyrtarisht i shkarkuar dhe zevendesohet menjehre.

Menyra dhe masa e shperblimit te drejtorit caktohen nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tij.

Neni 12

KOMPETENCAT E DREJTORIT

I. Drejtori ka kompetenca te plota ndaj te treteve per te vepruar ne emer te shoqerise ne çfardo rrethane, me perjashtim te kompetencave qe i jane caktuar shprehimisht keshillit mbikqyres nga ligji dhe nga ky statut.

Ne marredhenie me te tretet shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e drejtorit edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise, perveç rastit kur shoqeria provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorit kapercente objektin e shoqerise dhe vepronte me keqbesim, ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt, duke pasur parasysh faktin se vete shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Kufizimet e kompetencave te drejtorit te caktuara ne statut duhet te respektohen nga te tretet.

Megjithate, ne cilesine e masave te rregullimeve te brendshme te shoqerise, por qe nuk u kundervihet te treteve, veprimet dhe masat e meposhtme kryhen vetem me autorizim te keshillit mbikqyres.

- percaktimi dhe ndryshimi i programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesme dhe afatgjate te shoqerise.

- kryerja e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e buxhetit fillestar te shoqerise.

- hapja e veprimtarive ose e njesive te reja, shkrirja ose bashkimi dhe mbyllja teresisht e pjeserisht e veprimtarive dhe njesive te shoqerise.

- blerja, shkembimi dhe shitja e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise.

- themelimi i shoqerive ose pjesmarrja ne shoqeri te tjera te krijuara, ose per t'u krijuar.

- marrja e huave afatmesme, afatgjata, dhenia e dorezanive ose e garancive te tjera kur keto te fundit tejkalojne veprimtarite e zakonshme te shoqerise.

- negociimi, perfundimi a ndryshimi i çdo kontrate me afat mbi 3 vjet ose per nje shume detyrimesh vjetore mbi dy milione leke ;

- percaktimi i kriterëve per diskutimin, perfundimin dhe ndryshimin e kontrates se punesimit me punonjesit;

- ne pergjithesi marrja e vendimeve dhe masave qe e kapercëjne veprimtarine e zakonshme te shoqerise dhe qe jane te tilla qe mund te sjellin ndryshime ne objektin e shoqerise.

II. Drejtori i pergjithshem mund te delegoje nje pjese te kompetencave te tij, qe ai i gjykon te dobishme tek nje ose disa persona te tjera qe kryejne funksione teknike ne drjtimin e shoqerise.

III. Drejtori i pergjithshem perfageson shoqerine ne marredhenie me te tretet.

Emertimi dhe pushimi i tij duhet te publikohet ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Aktet, me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve, duhet te mbajne nenshkrimin e drejtorit te pergjithshem, ose te personit te autorizuar rregullisht nga drejtori per keto akte.

Eshte e detyrueshme qe çdo mardhenie ndermjet drejtorit te pergjithshem dhe keshillit mbikqyres te regjistrohet ose te pasqyrohet ne proçesverbal.

Maredheniet, brenda shoqerive percaktohen me rregullore te veçante te cilat miratohen ne keshillat mbikqyres te ketyre shoqerive.

Neni 13

MARREVESHJET NDERMJET SHOQERISE DHE DREJTORIT OSE NJE ANETARI TE KESHILLIT MBIKQYRES

Çdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe drejtorit te pergjithshem ose nje anetari te keshillit mbikqyres, gofte e drejteperdrejte ose joe e drejteperdrejte, duhet t'i nenshtrohet autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres.

Kjo dispozite eshte e zbatueshme edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerie tjeter, kur nj anetar i keshillit mbikqyres eshte edhe anetar i keshillit mbikqyres te shoqerise tjeter, me te cilen propozohet te lidhet marreveshja.

Dispozitat e mesiperme nuk jane te zbatueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimet rrjedhese te shoqerise qe kryhen ne kushtet normale.

Drejtori ose anetari mbikqyres i interesuar duhet te njoftoje keshillin mbikqyres sapo merr dijeni per nje marreveshje, per te cilen zbatohen kerkesat e ketij neni te satutit. Anetari i keshillit mbikqyres i intersuar nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit.

Neni 14

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

Kontrolli ushtrohet nga nje ose dy eksperte te autorizuar, te cilet emerohen nga keshilli mbikqyres dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

Neni 15

USHTRIMI FINANCIAR

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.

Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar gjer me 31 dhjetor.


Neni 16

INVENTARI-LLOGARITE VJETORE

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.

Ne mbyllje te ushtrimit, drejtori harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar.

Drejtori pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara per te ardhmen, ngjarjet me te rendesishme qe kane ndodhur gjate periudhes nga data e mbylljes te ushtrimit financiar deri ne daten e hartimit te ketij raporti, si dhe veprimtarite e shoqerise ne fushen kerkimore-shkencore.



Neni 17

REZULTATI I USHTRIMIT DHE CAKTIMI I FITIMEVE

Rezultati i ushtrimit percaktohet si difference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire te keto te fundit amortizimet dhe provizionet.

Nga fitimet e ushtrimit te pakesuara, kur eshte rasti, me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5 perqind per te krijuar rezerven e domosdoshme.

Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se geni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin nje te dhjeten e kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur per nje arsye cfardo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen nje te dhjeten e kapitalit.

Nga fitimet e ushtrimit te pakesuar, kur eshte rasti, me humbjet e meparshme, shoqeria do te heqe jo me shume se 85 perqind per krijimin e rezervave per zhvillim.

Shuma e fitimeve te mbetura pas heqjes per krijimin e rezervave te permendura me siper perfageson dividendin, i cili derdh ne buxhetin e shtetit.

Duke perjashtuar rastin kur eshte vendosur zvogelimi i kapitalit, nga fitimet e ushtrimit nuk behet asnje heqje dhe asnje derdhje dividendi, ne qofte se kapitalet e veta jane ose do te beheshin me te vogla se shuma e kapitalit themeltar plus shumen minimale te kerkuar per rezerven e domosdoshme.

Ne qofte se ekziston nje humbje, kjo mbartet per t'u perfshire ne fitimet e ushtrimit te ardhshme deri ne shuarjen e saj.

Neni 18

EMERIMI I ANETAREVE TE PARE TE KESHILLIT MBIKQYRES

Si anetare te pare te keshillit mbikqyres emerohen :

- | | |
|-------------------|------------------|
| - Z. Petraq Cama | banues ne Tirane |
| - Z. Ilir Zego | banues ne Tirane |
| - Z. Ilia Samsuri | banues ne Tirane |



Neni 19

EMERIMI DHE SHKARKIMI I DREJTORIT TE PARE

Ne nje afat prej 6 muajsh nga data e regjistrimit te shoqerise drejtori i ish ndermarrjes shteterore do te jete i emeruar zyrtarisht Drejtor i Pergjithshem i Shoqerise dhe do te jete pergjegjes per ruajtjen e pasurise te saj.

Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet vetem nga Ministri i Financave dhe per shkaqe te perligjura mbi bazen e propozimeve te Drejtorise te Shoqerive Publike ose te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise.

Hartuar ne 17.10.1995 me 6 kopje te njejta.

DREJTORI**I****DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE**

S T A T U T

I

SHOQERISE ANONIME FU – FARMA SH.A.

NENI 1

Forma e Shoqerise



Shoqeria do te jete shoqeri anonime pa oferte publike, per sa kohe qe Asambleja e aksionereve nuk do te marre nje vendim per shnderrimin e saj ne shoqeri me oferte publike, ose te nje forme tjeter te shoqerise tregtare te parashikuar nga ligji nr. 7638, date 19/11/1992 “Per shoqerite tregtare”

Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozitat perkatese te Ligjit 7638, date 19/11/1992 “Per shoqerite tregtare”, si dhe nga ky statut e legjislacioni ne fuqi.

NENI 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Objekti i veprimtarisë është: grumbullim, shperndarje, perpunim artikuj, pajisje, laboratore farmaceutike, mjekësore.

Import , eksport te artikujve , paisjeve laboratorike, farmaceutike mjekësore.

Brenda legjislacionit në fuqi, shoqëria do të kryejë çdo aktivitet financiar, tregtar që ka lidhje të drehtpërdrejtë ose të tërthortë me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

NENI 3

Emertimi i shoqerise

“FUFARMA “ sh.a. Në të gjitha dokumentet e shoqërisë do të jetë i shkruar emërtimi i shoqërisë i ndjekur nga inicialet “Sh.A.”.

NENI 4

Selia e shoqërise

Selia e shoqërisë ndodhet në adresë : Rr . “ Qemal STAFI”, Nr.7, Tirane

NENI 5

Kohezgjatja e shoqërise

Kohezgjatja e shoqërise është me afat të përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregëtar. Ky afat mund të ndërpritet me vendim të mbledhjes së jashtëzakonshme të Asamblesë së Aksionerëve, ose sipas dispozitave ligjore në fuqi (rasti i likuidimit të shoqërise në rrugë zyrtare)

NENI 6

Kapitali i shoqërise

Kapitali themeltar i shoqërise është 242.892.000 (.....) Lekë. Kapitali është i ndarë në aksione me vlerë nominale 1.000 lekë secili.

NENI 7

Ndryshimet e kapitali themeltar

Kapitali themeltar mund të zmadhohet në të gjitha mënyrat dhe modalitetet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi për këtë qëllim, si emetimi i aksioneve, rritja e vlerës nominale të aksioneve, etj.

Në bazë të nenit 152 të ligjit nr. 7638, datë 19/11/1992 “Për Shoqëritë Tregëtare”, i vetmi organ kompetent për të vendosur ndryshimin e kapitalit është Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, e cila merr vendime në bazë të raportit të Drejtorisë që përmban treguesit e kërkuar nga ligji.

Në përputhje me ligjin, aksionerët kanë përpjestimisht me shumën e aksioneve të tyre një të drejtë përcaktuar për nënshkrimin e aksioneve të para të emetuara për të

kryer nje zmadhim kapitali. Ata mund te heqin dore nga kjo e drejte vetem individualisht.

Asambleja e Jashtezakonshme vendos per zmadhimin e kapitalit sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Ne asnje rast zvogelimi i kapitalit nuk mund te cenoje propocionalitetin e aksionereve. Zvogelimi i kapitalit ne nje shume me te vogel se minimumi ligjor mund te vendoset me kushtin pezullues te nje zmadhimi te kapitalit, i destinuar te coje kane te fundit te pakten ne nje minimum ligjor, pervec rastit kur shoqeria transformohet ne nje shoqeri te nje forme tjeter qe nuk kerkon kapital me te larte se sa ak i zvogeluar.

Ne rastin e mosrespektimit te kesaj dispozite, cdo i interesuar mund te kerkoje nga gjykata kompetente prishjen e shoqerise.

Prishja e shoqerise nuk mund te shpallet nese ne ditën qe gjykata shqyrton ceshtjen, gjendja eshte rregulluar.

NENI 8

Aksioneret e shoqerise

Aksioneret e shoqerise mund te jene persona fizike dhe/ose juridike, qe kane ne zoterim aksionet e shoqerise sipas te gjitha menyrave te parashikuara nga ligji.

NENI 9

Te drejtat dhe detyrat e aksionereve

Cdo aksioner ka te drejten e pjesemarrjes ne fitimet e shperndashme te shoqerise ne propocion me aksionet qe zoteron, sipas vleres nominale te zoteruar ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Cdo aksioner ka te drejte te marre kur eshte rasti nje pjese nga teprica e likujdimi te shoqerise ne te njejtin perpjestim sipas paragrafit te pare te ketij neni.

Aksioneret kane te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne asamblene e pergjithshme ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi dhe nga ky statut. Aksioneret jane vete pergjegjes per detyrimet dhe per humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne. Kerkimi i fondeve tej kesaj mase eshte i ndaluar.

Te drejtat dhe detyrimet e permendura me siper ndjekin aksionin ne cfarëdo forme qe ai tjetersohet tek te tretet.

NENI 10

Forma e aksioneve dhe libri i aksioneve

Aksionet janë të formes nominative.

Pronesia e aksioneve rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit ose titullareve, në librin e aksioneve të mbajtur nga ana e shoqërisë ose ndërmjetesit financiarë.

Libri i aksioneve do të përmbajë në çdo kohë informatat që vijne : numrin dhe kategorinë e aksioneve, datën e marrjes nga aksioneri, emrin mbiemrin dhe adresën e çdo aksioneri si dhe vlerën nominale për çdo aksion të zotëruar.

Secili aksioner ka të drejtë të kërkojë me shkrim dhe të marrë një ekstrakt nga libri i aksioneve, i cili vertetohet me vulën e shoqërisë.

Secili aksioner ka të drejtë të verifikojë nëse është futur në librin e aksioneve dhe personi i cili mban librin e aksioneve është i detyruar t'i tregojë aksionerit me kërkesën e këtij të fundit, hyrjen përkatëse në liber.

Libri i aksioneve mbahet në selinë e shoqërisë.

NENI 11

Transferimi i aksioneve

Aksionet janë lirisht të transferueshme me miratimin e shoqërisë (neni 207). Në rastin e zmadhimit të kapitalit, aksionet janë lirisht të transferueshme pas realizimit të këtij zmadhimi.

Ndryshimi i pronësive të aksioneve si rrjedhojë e një transferimi kryhet nepermjet një kalimi nga llogaria e dhenesit tek llogaria e marresit në bazë të një urdher xhirimi.

Shoqëria do të kërkojë që nënshkrimet e paleve të vertetohen nga noteri ose organi i përcaktuar me ligj për realizimin e transferimit të aksioneve.

Transferimi i aksioneve falas si rrjedhojë e trashëgimise kryhet gjithashtu me anë të kalimit në llogari në bazë të një dokumenti ligjor që verteton transferimin.

Aksionet e pashlyera për derdhjet e kërkuara nuk mund të pranohen për transferim.

NENI 12

Shlyerja e aksioneve

Aksionet e nenshkruara ne para lidhur me zmadhimin e kapitalit duhet te shqyrtohen sipas modaliteteve te caktuara nga Asambleja e Jashtezakonshme. Shlyerja e tyre nuk mund te jete me e ulet se $\frac{1}{4}$ e vleres nominale dhe nese eshte rasti, e terejise se primeve te emisionit.

Shlyerja e vleres nominale te mbetur duhet te behet ne nje ose disa keste me kerkese te Drejtorise se shoqerise ne nje afat prej pese vjetesh nga data kur ky zmadhim i kapitalit eshte bere perfundimtar.

Kerkesat per shlyerjen e aksioneve u behen te njohura nenshkruesve te pakten pesembdhjete dite perpara dates se caktuar per cdo derdhje me leter rekomande me kthim pergjigje per marrje ne dorezim te adresuar tek cdo titullar i aksioneve.

Cdo vonese ne derdhjen e shumave te duhura nga shumat e pashlyera te aksioneve, sjell pagimin e interesave me perqindjet ligjore dhe kjo pavaresisht nga veprimi personal qe shoqeria mund te ushtroje ndaj aksionerit qe nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit te detyruar te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi per kete problem.

NENI 13

Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1. Asambleja e pergjithshme e aksionerve
2. Keshilli Mbikqyres
3. Drejtoria.

NENI 14

Asambleja e zakonshme

Asambleja e zakonshme merr te gjitha vendimet qe jane te percaktuara nga ligji ose nga ky statut, me perjashtim te rasteve kur vendimet perfshihen ne kompetencat e Asamblese se Jashtezakonshme.

Ajo merr vendim me nje shumice votash te percaktuara ne nenin 129 te ligjit 7638 date 19/11/1992 " Per Shoqerite Tregetare "

Ne Asamblene e Aksionereve do te merren aktet te cilat do te firmosen nga Kryetari i Asamblese, sekretari dhe noteri.

Keshilli Mbikqyres dhe Drejtoria do te therrasin mbledhjen e Asamblese.

Asambleja mund te thirret gjithashtu nga :

- Ekspertet kontabel te autorizuar.
- Nje mandatmbajtes i caktuar nga gjyqi, me kerkesen e cdo personi te interesuar per nje rast urgjent ose te nje apo disa aksionereve qe zoterojne te pakten 1/10 e kapitalit themeltar.
- Nga likujduesit.

Asambleja do te mbahet ne 6 muajt e pare te cdo viti fiskal.

Mbledhja e Asamblese kryhet me ane te nje lajmerimi qe permban informacion ligjor, ne menyre te tille qe te jete nje periudhe kohe prej te pakten dy javesh ndermjet dites se publikimit dhe mundesise se fundit per depozitim.

NENI 15

Cdo vlere nominale prej 1.000 lekesh perfaqeson vetem nje vote. E drejta e votes mund te ushtrohet me ane te nje autorizimi per te cilin kerkohet nje forme e shkruar (prokure)

Kushtet ne baze te te cilave aksionmbajtesit mund te ushtrojne te drejten e votes ne asamble, percaktohen ne ftesen per te marre pjese ne asamble per aq kohe sa nuk jane dhene certifikatat e aksionereve.

NENI 16

Mbledhjet e asamblese drejtohen nga kryetari i Keshillit Mbikqyres ose ne mungese te tij asambleja, zgjedh drejtues te mbledhjes se saj nje nga anetaret e pranishem si kryetar asambleje, gjithashtu caktohet edhe nje sekretare.

Drejtimi i mbledhjes se asamblese bazohet ne parashikimet e nenit 48 te ligjit nr.7667, date 28/01/1993 “ Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare “

Kryetari drejton asamblene dhe vendos mbi vazhdimesine, objektet e bisedimit dhe mbi menyren e votimit.

NENI 17

Asambleja e Jashtezakonshme

Asambleja e Jashtezakonshme do të thirret nëse përmbushen kushtet ligjore për një mbledhje të tillë.

Asambleja e Jashtezakonshme formon një quorum, nëse aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar zoterojnë të paktën 50 % të aksioneve me të drejtë vote. Në qoftë se përfaqësimi është më pak se 50 %, thirret një mbledhje e dytë. Mbledhja e dytë formon një quorum nëse aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar zoterojnë të paktën 25 % të aksioneve me të drejtë vote.

Asambleja merr vendim me shumicën prej $\frac{3}{4}$ që i perkasin aksioneve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Rezultati i votës mund të përcaktohet me anën e metodës së zbritjes së votave, po ose jo dhe abstenimit të votave të aksionmbajtësve të lejuara në total.

NENI 18

Bilancet financiare në fund të vitit, raporti mbi aktivitetin, raporti i Keshillit Mbikqyres dhe të gjitha projekt-vendimet e dokumentat e tjera të parashikuara me ligj, duhet të jenë në dispozicion të çdo aksioneri apo mandatmbajtësi të emeruar prej tij si përfaqësues në asamble, së paku 15 ditë përpara mbledhjes së asamblese në selinë e shoqërisë apo në selinë drejtuese administrative.

Çdo vit pas marrjes së raportit, i cili duhet të depozitohet në Keshillin Mbikqyres brenda 6 muajve të parë të vitit ushtrimor, asambleja e zakonshme vendos mbi zëvendësimin e Keshillit Mbikqyres, mbi përdorimin e fitimit neto të vitit, miratimin e bilancit dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji mbi përcaktimin e treguesve financiarë vjetorë.

NENI 19

Shoqëria nga fitimi i rezervuar gjatë vitit financiar, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm nëse ka të tilla, do të lere menjëherë një shumë me vlerë të paktën sa $\frac{1}{20}$ e tij, për krijimin e "rezerves së domosdoshme". Kjo lenie menjëherë nuk është me detyrueshmëri kur rezerva të arrijë shumën sa $\frac{1}{10}$ e kapitalit themeltar.

Nga krijimi i fondit rezerve dhe krijimi i fondeve të tjera të financimit asambleja e zakonshme vendos për zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit dhe investimeve në shoqëri.

NENI 20

Keshilli Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres mund te perbehet nga 3 (tre) deri ne 21 (njezetenje) anetare. Ky numer duhet t'i pershatet kerkesave dhe rrethanave ekonomike. Koha e ushtrimit te detyres per te gjithë anetaret eshte 1 (nje) vit.

Anetaret e keshillit Mbikqyres mund te japin doreheqjen nga detyra me anen e nje deklarate e cila duhet t'i dergohet Kryetarit te Keshillit Mbikqyres duke respektuar nje limit kohe prej dy javesh.



NENI 21

Kryetari dhe zv. Kryetari i Keshillit Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres zgjedh me shumice te thjeshte votash midis anetareve te tij nje kryetar dhe nje zv/kryetar. Zgjedhja e tyre behet ne mbledhjen e pare.

Ne qofte se kryetari ose zevendesesi i tij lirohen nga detyra para mbarimit te afatit, do te kryhet nje zgjedhje tjeter per periudhen e mbetur.

Ne pamundesi te ardhjes se kryetarit dhe zevendesit te tij detyrat do te kryhen nga anetari me i vjeter ne moshe.

Keshilli Mbikqyres mund te percaktoje rregulla te brendshme lidhur me proceduren e punes. Drejtoria e shoqerise mund te marre pjese ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres ne qofte se dhe kur ky keshill kerkon prezencen e tyre.

NENI 22

Deklaratat e Keshillit Mbikqyres do te jepen ne emer te ketij keshilli nga Kryetari dhe ne mungese te tij nga zv. Kryetari.

NENI 23

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres thirren me shkrim nga Kryetari dhe ne mungese te tij nga zevendesesi i tij. Lajmerimi behet 15 dite perpara. Ne raste urgjente lajmerimi mund te behet brenda nje kohe me te shkurter dhe ftesa mund te komunikohet gojarisht, me telefon, faks, teleks ose telegram.

Ne kete ftese duhet te specifikohet rendi i dites.

Ndonje anetar i keshillit mund te shtojte ceshtje ne rendin e dites te cilat duhet t'i behen te njohura Kryetarit me ane te nje letre te pakten 10 dite perpara mbledhjes. Te gjithë anetaret e keshillit duhet te informohen pa vonese mbi shtesat e rendit te dites.

NENI 24

Nese te gjithë anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te ftuar ne kohen e duhur dhe te pakten gjysma e numrit legal eshte e pranishme, atehere keshilli formon nje quorum. Miratimi i nje rezolute e cila nuk ka qene ne rendin e dites eshte e lejueshme vetem nese asnje nga anetaret e pranishem te keshillit nuk kundërshton rezoluten dhe te pakten 2/3 e anetareve jane te pranishem.

Mbledhja do te drejtohet nga Kryetari dhe ne mungese te tij nga zevendesi i tij. Kryetari vendos radhen e rendit te dites, llojin dhe radhen e votimit.

Vendimet e keshillit do te miratohen me maxhorance te thjeshte.

Ne rast barazimi votash, Kryetarit i jepet e drejta e dy votave.

NENI 25

Procesverbalet e mbledhjeve te Keshillit Mbikqyres duhet te pergatiten dhe te nenshkruhen nga drejtuesi perkates i mbledhjes.

NENI 26

Keshilli Mbikqyres kontrollon Drejtorine e shoqerise.

Keshilli Mbikqyres mund te percaktoje nje liste te masave dhe veprimeve te cilat duhen te ndermerren nga Drejtoria. Kjo eshte vecanerisht e vlefshme per politiken e objekteve te biznesit, investimit dhe financimit, fushat e veprimit te shoqerise dhe drejtimin e kontrates.

Keshilli Mbikqyres ka te drejte te mbikqyre ne cdo kohe administrimin e shoqerise nga Drejtoria.

Drejtoria e shoqerise eshte e detyruar te vere ne dijeni Keshillin Mbikqyres sipas menyres se percaktuar ne ligj.

NENI 27

Keshilli Mbikqyres eshte organi kompetent qe miraton marrjen e kredive apo huave, te propozuara nga Drejtoria per te siguruar mjetet financiare te perkohshme afatgjata ose afatshkurtra, si dhe ne forma te tjera te mundshme sipas normave qe e lejojne mobilizimin e mjeteve financiare.

NENI 28

Anetarët e Keshillit mbikqyres dhe anetarët e Drejtorise, duhet te ruajne menyren e gjykimit dhe te veprimit ne lidhje me informacionin konfidencial dhe sekretet e shoqerise, vecanerisht ato industriale dhe te biznesit.

Informacioni lidhur me shoqerine mund t'i transferohet paleve te treta vetem me miratimin e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres dhe me kusht qe te mos rezikojë interesat e shoqerise.

Nese palet e treta kane marre pjese ne mbledhjen e keshillit, ato duhet te ruajne maturine.

NENI 29

Anetarët e Keshillit Mbikqyres pervec kompensimeve per shpenzimet e tyre, do te marrin dhe nje pagese mujore. Kjo page do te fiksohet ne asamblene e aksionereve me nje mazhorance prej 2/3 e votave dhe jepet ne fund te cdo muaji.

NENI 30

Drejtoria e shoqerise mund te perbehet nga nje ose disa persona fizikë. Emërimi i anetareve zevendes te Drejtorise eshte i lejueshem. Ata kane te drejta sikunder anetarët e tjere te Drejtorise, persa i perket formes se jashtme te perfaqesimit.

Do te kryhen nga Keshilli Mbikqyres :

A) Percaktimi i numrit te anetareve te drejtorise

B) Miratimi i stafit drejtues qe drejtoria propozon per kryerjen e aktivitetit.

C) Emerimi i Drejtorit dhe zv/Drejtorit te Pegjithshem.

D) Caktimi i mases se shpenzimeve qe drejtoria eshte e detyruar te kryeje per pritje percjellje , etj.

NENI 31

Nese drejtoria perbehet nga disa persona, do te percaktohen rregullat e perhershme te cilat do ti nenshtrohen aprovimit te Keshillit Mbikqyres.

Vendimet e Drejtorise se shoqerise do te miratohen me maxhorance votash, ne rast barazimi vota e Drejtorit te Pergjithshem te Shoqerise eshte percaktuese.

Ne rast se ai mungon, kjo kompetence i kalon Zv/Drejtorit.

NENI 32

Nga ana ligjore Shoqeria perfaqesohet nga Drejtoria e shoqerise. Drejtoria e shoqerise eshte e detyruar para shoqerise te respektojë kufizimet e percaktuara me ligj, statutin dhe Keshillin Mbikqyres lidhur me hapësiren e autoritetit te tij kontrollues.

NENI 33

Shoqeria mund te bashkohet ose te ndahet me shoqeri te tjera me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme, me shumice votash te aksionereve sipas kriterëve te percaktuara per ndryshimin e statudit te shoqerise.

Ne rastin e ndarjes e bashkimit te shoqerise, zbatohen dispozitat e seksionit IV te ligjit 7638, date 19/11/1992 " Per shoqerite tregtare "

NENI 34

Likujdimi i shoqerise vendoset nga Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve kur per kete jane dakort shumica e quorumit per marrjen e vendimit ne kete asamble.

Vendimi i likujdimit te shoqerise duhet t'u behet i njohur te gjithe aksionereve te shoqerise nepermjet publikimit ne mjetet e informacionit publik.

Procesi i likujdimit te shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e seksionit te V te ligjit nr 7638, date 19/11/1992 " Per shoqerite tregtare "

NENI 35

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Cdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe /ose interpretimin e ketij statuti, aksioneret do te perpiqen ti zgjidhin me mirekuptim, ne rast te kundert secili prej tyre ka te drejte t'i drejtohet per zgjidhje Gjykates se Shkallës së Parë Tiranë.

AKSIONERET





FUFARMA Sh.a.

Pharmaceutical Distributor

Nr. 8 Prot.

Tiranë, më 24.05.2007

AUTORIZIM

Shoqëria jonë do të kryejë depozitimin në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të Vendimit Nr.2, datë 04.04.2007 të Këshillit Mbikqyrës për zëvendësimin e Drejtorit të shoqërisë. Autorizojmë Z.Agron SHEHAJ, jurist pranë shoqërisë sonë, të na përfaqësojë përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjatë të gjithë procedurës së nevojshme.

DREJTORI

Dani BERBERI





FUFARMA Sh.a.


Pharmaceutical Distributor

Nr. 60 Prot.

Tiranë, më 04.04.2007

VENDIM

NR.2 DT.04.04.2007



Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë Fufarma Sh.A. i përbërë prej Z.Isuf A. BERBERI, Znj.Henrieta BALLIU dhe Z.Nazmi ALIBALI, në mbledhjen e datës 04.04.2007, pasi diskutoi në lidhje me dorëheqjen e parevokueshme të paraqitur nga Drejtori i shoqërisë Z.Agron SHEHAJ me shkresën Nr.57Prot., Dt.03.04.2007, e cila u pranua nga Këshilli Mbikqyrës,

duke pasur parasysh rëndësinë që ka drejtimi efikas dhe përcaktimi i strukturës së Drejtorisë në mbarrëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë dhe gjendjen e vështirë aktuale të shoqërisë,

në bazë të nenit 97 e në vijim të Ligjit Nr.7638, Dt.19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe nenit 30 të Statutit të shoqërisë,

VENDOSI:

1. Të pranohet dorëheqja e Z.Agron SHEHAJ.
2. Drejtor i shoqërisë emërohet Z.Doni BERBERI.
3. Paga e Drejtorit të jetë 70.000 (shtatëdhjetë mijë) Leke.
4. T'i komunikohen ndryshimet e lartpërmendura bankave me të cilat kemi marrëdhënie. Në këto të fundit si dhe në ato me të cilat do të kontaktojmë në të ardhmen, të depozitohet si firmë e parë Z.Doni BERBERI. Në momentin e depozitimeve të lartpërmendura, depozitimet e mëparshme bëhen të pavlefshme përsa i përket firmës së parë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Isuf A. BERBERI

ZV/KRYETARI

Henrieta BALLIU

ANËTAR

Nazmi ALIBALI



Rruga "Qemal Stafa" No 7 Tirana - Albania Tel +355 4 360 000 E-mail fufarma@fufarma.com Savings Bank of Albania
Acc.166/3613- National Commercial Bank Acc.456/10-Alpha Bank Acc. 020465011005988-Fiscal code 3604280-Nat. J61825037N

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE ALIDA STAMO
Nr. 164 Rep. Nr. 356 Kol.

Tirane 10.05.2007

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 10 maj 2007 , ditën e enjte, ora 13.00, para meje noteres ALIDA STAMO, me zyre te ndodhur ne rrugen " Jordan Misja" pallati nr 99, u paraqiten personalisht:

ISUF BERBERI , i identifikuar me pasaporte nr Z 0229481

NAZMI ALIBALI , i identifikuar me pasaporte nr Z1260973

HENRIETA BALLIU e njohur eprsonalisht nga an aime

Te gjithë madhor me zotesi te plote per te vepruar.

Te siperpermendurit me deklaruan se jashte kesaj zyre noteriale kane hartuar Vendimin nr 2 date 4.04.2007 te Keshillit Mbikqyres se shoqerise " Fu Farma " sh.a. me cilesine e Kryetarit, Zv/ Kryetares , dhe antratit te ketij Keshilli te cilen e nenshkuar para meje.

Une noterja ne baze te ligjit vertetoj nenshkrimin e tyre ne kete akt .

NOTERE

ALIDA STAMO



KËRKESË

KËRKUES : Doni BERBERI, i biri i Aranitit dhe i Marçellës, i datëlindjes 30.05.1972, lindur në Vlorë dhe me banim në Tiranë në adresën Rruga "Mihal Grameno", Pall. 78/1, Ap.7, i identifikuar me Pasaporten nr.Z1345831 me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë anonime "FUFARMA" sh.a.

OBJEKTI : Depozitimi në Regjistrin Tregtar i Vendimit Nr.2, datë 04.04.2007 të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "FUFARMA" sh.a. Tiranë

Baza Ligjore : Ligji Nr.7632, datë 04.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar" me ndryshimet përkatëse, Ligji Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", Ligji Nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare"

PËRPARA : *Se depozitimi i kësaj lloje*
balut me kërkesë dhe shprehje
GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Me Vendimin Nr.12730, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, është vendosur regjistrimi si person juridik i shoqërisë aksionere "FUFARMA" sh.a. Tiranë.

Me Vendimin Nr.2, datë 04.04.2007, Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë, pasi ka pranuar dorëheqjen e parevokueshme të Z.Agron SHEHAJ si Drejtor i shoqërisë, ka vendosur :

1. Të pranohet dorëheqja e Z.Agron SHEHAJ.
2. Drejtor i shoqërisë emërohet Z.Doni BERBERI.
3. Paga e Drejtorit të jetë 70.000 (shtatedhjetë mijë) Leke.
4. T'i komunikohen ndryshimet e lartpërmendura bankave me të cilat kemi marrëdhënie. Në këto të fundit si dhe në ato me të cilat do të kontaktojmë në të ardhmen, të depozitohet si firmë e parë Z.Doni BERBERI. Në momentin e depozitimeve të lartpërmendura, depozitimet e mëparshme bëhen të pavlefshme përsa i përket firmës së parë.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, kërkoj nga kjo gjykatë depozitimin në Regjistrin Tregtar të Vendimit Nr.2, datë 04.04.2007 të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë. Bashkëlidhur keni edhe një kopje të vendimit të lartpërmendur.

Tiranë, më 04.05.2007

KËRKUES
Doni BERBERI
Doni
1946
Tirana - Albania

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE ALIDA STAMO
Nr. 166 Rep. Nr. 99 Kol.

Tirane 10.05.2007

VERTETIM NENSHKRIMI


Sot me date 10 maj 2007, ditën e enjte, ora 13.00 para meje noteres ALIDA STAMO, me zyre te ndodhur ne rrugen "Jordan Misja" pallati nr 99, u paraqiten personalisht:

DONI BERBERI, i biri i Aranitit dhe Marcelels, lindur ne Vlore dhe me banim ne Tirane, rruga „Mihal Grameno“ pallati nr 78/1 ap.7, i datelindjes 30.05.1972, i identifikaur me pasaporte nr **Z1345831** madhor me zotesi te plote per te vepruar, me cilesine e Drejtorit te shoqerise „Fufarma“, sh.a.

I siperpermenduri me deklaroi se jashte kesaj zyre noteriale ka hartuar kerkesen per depozitim ne regjistrin tregetar te vendimit nr 2 date 04.04.2007 te Keshillit Mbikqyres te shoqerise „FuFaram“, sh.a. te cilen e nenshkroj para meje. Une noterja ne baze te ligjit vertetoj nenshkrimin e tyre ne kete akt.

NOTERE

ALIDA STAMO



(11)

KËRKESË

11 MAG 2007

KËRKUES : Doni BERBERI, i biri i Aranitit dhe i Marcellës, i datëlindur 30.05.1972, lindur në Vlorë dhe me banim në Tiranë në adresën Rruga "Mihal Grameno", Pall. 78/1, Ap.7, i identifikuar me pasaportën nr Z1345831 me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë anonime "FUFARMA" sh.a.

OBJEKTI : Depozitimi në Regjistrin Tregtar i Vendimit Nr.2, datë 04.04.2007 të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "FUFARMA" sh.a. Tiranë

Baza Ligjore : Ligji Nr.7632, datë 04.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar" me ndryshimet përkatëse, Ligji Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", Ligji Nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare"

PËRPARA :

**GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË**

Me Vendimin Nr.12730, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, është vendosur regjistrimi si person juridik i shoqërisë aksionere "FUFARMA" sh.a. Tiranë.

Me Vendimin Nr.2, datë 04.04.2007, Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë, pasi ka pranuar dorëheqjen e parevokueshme të Z.Agron SHEHAJ si Drejtor i shoqërisë, ka vendosur :

1. Të pranohet dorëheqja e Z.Agron SHEHAJ.

2. Drejtor i shoqërisë emërohet Z.Doni BERBERI.

3. Shoqëria nuk do të ketë një ZvDrejt.

4. Të komunikohen ndryshimet e lartpërmendura bankave me të cilat kemi marrëdhënie. Në këto të fundit si dhe në ato me të cilat do të kontaktojmë në të ardhmen, të depozitohet si firmë e parë Z.Doni BERBERI. Në momentin e depozitimeve të lartpërmendura, depozitimet e mëparshme bëhen të pavlefshme për sa i përket firmës së parë.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, kërkoj nga kjo gjykatë depozitimin në Regjistrin Tregtar të Vendimit Nr.2, datë 04.04.2007 të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë. Bashkëlidhur keni edhe një kopje të vendimit të lartpërmendur.

Tiranë, më 04.05.2007

KËRKUES

Doni BERBERI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE ALIDA STAMO
Nr. 166 Rep. Nr. 59 Kol.

Tirane 10.05.2007

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 10 maj 2007 , ditën e enjete , ora 13.00 para meje noteres ALIDA STAMO, me zyre te ndodhur ne rrugen " Jordan Misja" pallati nr 99, u paraqiten personalisht:


DONI BERBERI , i biri i Aranitit dhe Marcellel, lindur ne Vlore dhe me banim ne Tirane , , rruga „ Miha! Grameno“ pallati nr 78/1 ap.7, i datelindjes 30.05.1972, i identifikuar me pasaporte nr **Z1345831** madhor me zotesi te plote per te vepruar , me cilesine e Drejtorit te shoqerise „ Fufarma „ sh.a.

siperpermenduri me deklaroi se jashte kesaj zyre noteriale ka hartuar kerkesen per depozitim ne regjistrin tregetar te vendimit nr 2 date 04.04.2007 te Keshillit Mbikqyres te shoqerise „ **FuFaram** „ sh.a. te cilen e nenshkroj para meje.

Une noterja ne baze te ligjit vertetoj nenshkrimin e tyre ne kete akt .

NOTERE

ALIDA STAMO



TIRANE

(TR)

z. / zj. MENTOR

SENGLA

Shoqëria Anonime "FUFARMA" - Tiranë njofton se ditën e Merkure, më datë 3/05/2006 do të mbledhet Asambleja e Zakonshme e aksionerëve të kësaj Shoqërie me këtë rend dite:

- 1- Miratimi i raportit mbi aktivitetin ekonomik-financiar të shoqërisë Fufarma SH.A. (bilancit) për vitin 2005
- 2- Rizgjedhja e anetareve të Keshillit Mbikqyres, përcaktuar sipas Statutit të shoqërisë

Asambleja do të zhvillohet në orën 10.00 pranë Selisë e Shoqërisë.

Çdo aksioner ka të drejtë të konsultojë dokumentacionin përkatës të kësaj mbledhje pranë shoqërisë, çdo ditë pune deri në ditën e mbledhjes së asamblesë.

Këtu më poshtë po ju dërgojmë fletën tuaj të votimit e cila do të përdoret për të aprovuar ose kundër - shtuar vendimet e kësaj asambleje. Mos harroni ta merrni me vete ditën që do të zhvillohet asambleja ! Ju lutemi që për çdo informacion që do të kërkonti t'i drejtoheni Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve, adresa dhe numri i telefonit të së cilës janë si më sipër. Kjo qendër ka kënaqësinë t'ju ofrojë ndihmë.

NR. MNTSNGE2444

z. / zj. MENTOR

SENGLA

AKSIONE:

1040

Shënim:

Kjo fletë votimi është e vlefshme vetëm për datën e shënuar mëposhtë.

Sasia e votave është e barabartë me numrin e aksioneve që zotëron aksioneri.

Fleta e votimit është e vlefshme vetëm nëse shoqërohet me letërnjoftim ose me prokurë përfaqësimi

Mentor Sencla
[Signature]

3 Maj 2006

Adresa: L.2 Rr.ARKITEKT SINANI, Nr.128

TIRANE

(TR)

z. / zj. LUAN

SEGLA

Shoqëria Anonime "FUFARMA" - Tiranë njofton se ditën e Merkure, më datë 3/05/2006
do të mbledhet Asambleja e Zakonshme e aksionerëve të kësaj Shoqërie me këtë rend dite:

- 1- Miratimi i raportit mbi aktivitetin ekonomiko-financiar të shoqërisë Fufarma SH.A. (bilancit) për vitin 2005
- 2- Rizgjedhja e anetareve të Keshillit Mbikqyres, përcaktuar sipas Statutit të shoqërisë

Asambleja do të zhvillohet në orën 10.00 pranë Selisë e Shoqërisë.

Çdo aksioner ka të drejtë të konsultojë dokumentacionin përkatës të kësaj mbledhje pranë shoqërisë,
çdo ditë pune deri në ditën e mbledhjes së asamblesë.

Këtu më poshtë po ju dërgojmë fletën tuaj të votimit e cila do të përdoret për të aprovuar ose kundër -
shtuar vendimet e kësaj asambleje. Mos harroni ta merrni me vete ditën që do të zhvillohet asambleja !
Ju lutemi që për çdo informacion që do të kërkonti t'i drejtoheni Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve,
adresa dhe numri i telefonit të së cilës janë si më sipër. Kjo qendër ka kënaqësinë t'ju ofrojë ndihmë.

NR. LNUSNGC1652

zj. LUAN

SEGLA

AKSIONE:


1040

Shënim:

Kjo fletë votimi është e vlefshme vetëm për datën e shënuar mëposhtë.

Sasia e votave është e barabartë me numrin e aksioneve që zotëron aksioneri.

Fleta e votimit është e vlefshme vetëm nëq shoqërohet me letërnjoftim ose me prokurë përfaqësimi



3 Maj 2006

Adresa: L.2 Rr.QEMAL STAFI, Nr.476/2

TIRANE

(TR)

z. / zj. ROLAND

MARTINI

Shoqëria Anonime "FUFARMA" - Tiranë njofton se ditën e Merkurë, më datë 3/05/2006
do të mbledhet Asambleja e Zakonshme e aksionerëve të kësaj Shoqërie me këtë rend dite:

- 1- Miratimi i raportit mbi aktivitetin ekonomik-financiar të shoqërisë Fufarma SH.A. (bilancit) për vitin 2005
- 2- Rizgjedhja e anetareve të Keshillit Mbikqyres, përcaktuar sipas Statutit të shoqërisë

Asambleja do të zhvillohet në orën 10.00 pranë Selisë e Shoqërisë.

Çdo aksioner ka të drejtë të konsultojë dokumentacionin përkatës të kësaj mbledhje pranë shoqërisë,
çdo ditë pune deri në ditën e mbledhjes së asamblesë.

Këtu më poshtë po ju dërgojmë fletën tuaj të votimit e cila do të përdoret për të aprovuar ose kundër -
shtuar vendimet e kësaj asambleje. Mos harroni ta merrni me vete ditën që do të zhvillohet asambleja !
Ju lutemi që për çdo informacion që do të kërkontë t'i drejtoheni Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve,
adresa dhe numri i telefonit të së cilës janë si më sipër. Kjo qendër ka kënaqësinë t'ju ofrojë ndihmë.

NR. RLNMRTC0859

z. / zj. ROLAND

MARTINI

AKSIONE:

120

Shënim:

Kjo fletë votimi është e vlefshme vetëm për datën e shënuar mëposhtë.

Sasia e votave është e barabartë me numrin e aksioneve që zotëron aksioneri.

Fleta e votimit është e vlefshme vetëm nëq shoqërohet me letërnjoftim ose me prokurë përfaqësimi

3 Maj 2006

Rufi Hara Pjese me mbledhje

z. / zj. **SOLANDI** **BRAJA**

Ne baze te nenit 33 te Ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitet qe duhen plotesuar ne te" kerkojme nga ana e gjykates tuaj te behen ndryshimet ne aktet e themelimit te saj per shtimin e kapitalit. Shoqeria te ciles i behet shtimi i kapitalit nuk ka kaluar akoma ne procesin e transferimit te aksioneve.

Bashkangjitur kesaj kerkese jane :

1. Urdheri i Ministrit te Financave me cilesine e aksionerit te vetem, ne baze te paragrafit te dyte te nenit 4 te Ligjit 7926, date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare".

2. Akti i vleresimit te truallit, qe behet shtese kapitali, ne baze te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.312, date 30.6.1994, "Per cmimin e truallit qe shitet dhe per qerane e truallit qe jepet ne perdorim personave fizike e juridike".

DREJTORI



BERZH PIRANIAN

12.12.1996
Sh. 9.5.1996
Urdheri i aksioneve
Sh. A. FU-FARMA
Urdheri i aksioneve

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E SHOQERIVE PUBLIKE

URDHER

I

AKSIONISTIT TE VETEM TE SHOQERISE ANONIME
"FU-FARMA"

TIRANE

Nr.72/1 date 5. 5. 1996

Me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise anonime "FU-FARMA" TIRANE, cilesi kete qe e kam ne baze te paragrafit te dyte te nenit 3 te Ligjit Nr.7926, date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" dhe ne baze te nenit 128 te Ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare";

Urdheroj:

1. Ne aktet e themelimit te shoqerise anonime "FU-FARMA" TIRANE, te behen ndryshimet e meposhtme:

Ne kapitalin themeltar te shoqerise te shtohet vlere e truallit prej 10.512.800 leke dhe numri i aksioneve 10.512, si dhe me nje siperfaqe prej 13141 m². Keto ndryshime te behen ne piken 4 te Aktit te Themelimit dhe ne nenin 3 te Statutit te Shoqerise.

2. Vleresimi i truallit, qe do te behet shtese ne kapital sipas pikes se mesiperme, te behet sipas dispozitave ne fuqi.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shoqerive Publike te beje veprimet perkatese per shtimin e kapitalit ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit Nr.7667 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen kryer ne te".



MINISTRI
DYLBER VRIONI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASERIA TIRANES

DREJT. ADMIN. FINANCIARE

Nr. 6738/ Prot.

Tirane, me 30/4/ 1996

VLERESIM TRUALLE PER SHOQERITE TREGTARE

ZBATIMI I V.K.M. NR. 312

Emertimi i objektit Ndërmirja FU - Ferma Tirane

Adresa Rruga Arqitekt Janina

Destinacioni

Sipërfaqja e objektit përcaktuar në gjuhën m² 13141 m²

Çmimi në lek/m² sipas kategorisë: C

a)Kategoria A _____

b)Kategoria B _____

c)Kategoria C 13141 x 800 = 10512800 lek

Ky vleresim behet në 3 kopje.



... qvartale të rregullta, të cilat në origjin
të ekspertit të bashkëpunimit për veprimin e bërë të verifikimit të bilancit
të shoqërisë ... *Erregjetare* ... që krijohet nga
transferrimi i *Ind. Turviz Art. Farmaceutik* për shkak të raportit të ve
primit:

Nga data *15/8/1995*, deri me datën *31/8/1995* dhe
nëseur përveç e Komisionit të Administrimit dhe të percaktimit
të kapitalit themelues të shoqërisë që në të krijohet nga
transferrimi i saj.

- Nga verifikimet e kryera konstatohet se, Komisioni i
respektuar rregullat e parashikuara në vendimin e Këshillit të
Ministrave Nr.311 datë 12/06/1995 "Për kriteret e percaktimit të
kapitalit themelues të shoqërive shtetërore në shoqëri të regjistruara"
si dhe ato të percaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financave
Nr.9 datë 27/06/1995 dhe numer 3/1 datë 02/08/1995 për ato
vëllime.

- Regjistrimet të tabelave për veprimet që bëhen në
percaktimin e kapitalit themelues në përputhje me datën 27/06/1995
konstatohet.

- Niveli i ndërtimit të shprehur në përqindje të bilancit
të shoqërisë ...

232 380 000

Proti

Ndërmëse Furnizim Prilëv
Per me outlt.
Libranc

BILANCI

I

RIFORMUAR

PER EFEKT TE TRANSFORMIMIT NE SHOQERI TREGTARE

AKTIVET:	Shuma e riformuar me rastin e transformimit	Shuma me 31.12.1994
I. AKTIVET E QENDRUESHME	30.903.698 ⁴⁰	12.451.634 ²⁰
a. Trualli		
b. Aktivete tjera te qendrueshme	30.903.698 ⁴⁰	12.451.634 ²⁰
- Vlera kontabel bruto	50.642.134 ⁴⁰	21.479.500 ¹⁵
- Amortizimi (-)	19.738.436	9.027.865 ⁶⁰
II. GJENDJE TE INVENTARIT	222.097.194 ⁹⁵	235.102.982 ⁹⁵
1. Materiale	535.860 ²⁵	535.860 ²⁵
2. Objekte te inventarit	89.170 ³⁵	89.170 ³⁵
3. Prodhim ne proces		
4. Produkte dhe mallra	219.472.163 ⁸⁵	234.477.951 ⁸⁵
5. Te tjera		
III. KERKESA MBI TE TRETET	113.832.991 ⁸⁰	113.832.991 ⁸⁰
1. Kliente	112.041.780 ⁵⁰	112.041.780 ⁵⁰
2. Kerkesa te tjera	1.791.211 ³⁰	1.791.211 ³⁰
IV. LIKUIDITETE DHE VLERA ARKE.	345.485.111 ⁹⁰	345.485.111 ⁹⁰
1. llogari ne banke	335.901.703 ²⁰	335.901.703 ²⁰
2. Arka		
3. Te tjera (banke llogj kompjuterike)	9.583.408 ⁷⁰	9.583.408 ⁷⁰
V. LLOGARI RREGULLIMI	136.100	136.100
1. Shpenzime avance	136.100	136.100
2. Te tjera		
VI. AKTIVE TE PAPERFSHIRA NE KAPITAL		
TOTALI I BILANCIT	710.455.097 ⁰⁵	707.008.821 ²⁰
VII. SHPENZIME		
TOTALI I PERGJITHSHEM		

PASIVI:	Shuma e reformuar me rastin e transformimit	shuma me 31.12.1994
I. KAPITALI THEMELTAR	232 380 000 ⁸⁰	23 653 364 ⁸⁰
II. REZERVA NGA RIVLERESIMI	1 500 000	
III. REZERVAT	31 253 457 ⁸⁰	50 396 947 ⁸⁰
1. Rezerva e kapitalit	3 500.000	27 352 461 ⁸⁰
2. Rezerva e zhvillimit	23 000.000	14 534 122 ⁸⁰
3. Rezerva per shperblimin suplementar	3 053 457 ⁸⁰	6 587 672
4. Rezerva per ndihma te menjehershme	1 700.000	1 922 722
5. Rezerva per ndertim banese per punonjesit		
IV. FITIME OSE HUMBJE TE MBARTURA		
V. FITIME OSE HUMBJE TE USHTRIMIT		28 910 110 ⁸⁰
VI. PROVIZIONE PER RREZIQE DHE SHPENZIME	21 895 334 ⁸⁰	-
VII. DETYRIMET	423 426 304 ⁸⁰	423 426 304 ⁸⁰
1. Hua bankare (banka botron)	85 156 252	85 156 252
2. Fond kunderparti	-	
3. Furnitore	111 338 135 ⁸⁰	111 338 135 ⁸⁰
4. Te tjera detyrime	226 931 917 ⁸⁰	226 931 917 ⁸⁰
VIII. DETYRIM NDAJ SHTETIT PER AKTIVE TE PA PERFSHIRA NE KAPITALIN E SHOQERISE		
IX. LLOGARI RREGULLIMI	-	180 622 065 ⁸⁰
-		
-		
TOTALI I BILANCIT	710 455 097 ⁸⁰	707 008 821 ⁸⁰
X. TE ARDHURAT		
TOTALI I PERGJITHSHEM		

KOMISIONI I VLERESIMIT

(Loket Daja)
Daja
Lumtur' Boshja
[Signature]

(Loket Loci)
Loci
Skender Gornica
[Signature]

(Pjerdije Dora)
Dora
Meriton Mami
[Signature]



1273

Proces - verbal

i mbledhjen e parë, me datë 03 XI. 1951

Lot, me datë 03.11.1951, kurre me fjalë.
Gjurmë Noti e bje e Thoolhorit, datë 1951,
lindur me gjatësi brenore në tironi,
me arritje të baste përmirë e ulë fep!

Byj pyet me listën e
ekspertëve të mikotivës pye,
Ministria i Financave, për caktimin
për vlerësimin e kësaj lloji të kësaj
- lloji të udh. furnizimit artikuj
farmaceutikë dhe.

Nkam arritje të baste në shprehje
pe do të kësaj.

S'plotësoj arritje pye kësaj e
përshkrimet pye përmet 168 e 169
te fjet 7638 datë 15 XI 1952.

Gjurmë
Gjurmë Noti
Noti

Gjurmë
Gjurmë

DOKUMENTACIONI QE PERMBAN DOSJA

- 1. Urdher i Ministrit te Financave per transformimin e ndermarrjeve**
- 2. Kerkese per miratimin e eksperteve kontabel per vleresimin e kapitalit themeltar te shoqerise anonime.**
- 3. Kerkese per rregjistrimin e shoqerise tregtare anonime si person juridik.**
- 4. Akt-themelimi i shoqerise anonime.**
- 5. Statut i shoqerise anonime.**
- 6. Bilanci i riformuar per efekt te transformimit ne shoqeri tregtare.**
- 7. Raport i eksperteve kontabel.**
- 8. Vendim i gjyqtarit te vetem per miratimin e eksperteve kontabel**
- 9. Vendim per rregjistrimin e personit juridik.**
- 10. Relacion i drejtorise se shoqerive publike, ne ministrine e financave.**
- 11. Urdher rregjistrimi.**

G J Y Q T A R E

RELACION

GJYKATES SE RRETHIT
TIRANE

Sipas ligjit nr. 7926 dt.20.04.1995 "Per transformimin e ndermarjeve ne shoqeri tregtare", ne nenin 7 te saj thuhet se "rregjistrimi i shoqerive qe krijohen nga transformimi i ndermarjeve duhet te kryhet brenda dates 31.08.1995. Pas kesaj date te gjitha ndermarrjet qe nuk jane rregjistruar brenda ketij afati kalojne nen kujdestarine e Drejtirise se Shoqerive Publike ne Ministrine e Financave.

Duke u nisur nga sa me siper, mund te themi se paraqitja e dokumentacionit nga ana e ndermarjes Furnizim Artilej Farmaceutik nuk eshte paraqitur ne afatin e percaktuar ne ligj, per arsye objektive si:

1. Komisionet e vleresimit nuk e kane perfunduar ne kohe rivleresimin e ndermarrjes.
2. Kajne pasur veshtiresi ne marrjen e gent-planit te ndermarjes ne seksionet e urbanistikes se rrethit.
3. Percaktimi i vleres se tokes per m2, per kete ndermarje, nga ana e seksioneve te finances se urbanistikes se rrethit.

Per keto arsye ju kerkojme te beni rregjistrimin e kesaj ndermarjeje si shoqeri tregtare.

DREJTORI
DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE TIRANE

BERZH PIRANIAN

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E SHOQERIVE PUBLIKE

URDHER

Nr. 72 Date 26.10.1995

Ne baze te nenit 4 te Ligjit Nr.7926 date 20.4.1995. "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare",

Urdheroj:

1. Transformimin e ndermarrjes Furnizim Artikuj Farmaceutik Tirane, ne shoqeri te formes anonime Sh.A. "Furnizim Artikuj Farmaceutik" ose shkurt "FU-FARMA" Tirane.

2. Anetar te keshillit mbikqyres caktohen :

1. Ilir Beqo

2. Ilia Samsuri

Anetaret e tjere te keshillit mbikqyres emerohen nga Ministra e Shendetesise.

3. Ekspertet per vleresimin e kapitalit themeltar te tyre caktohet Garrufa Noti.

Veprimet per vleresimin e kapitalit dhe te rregjistrimit ne shoqeri te mbarojne brenda dates 31.8.1995.

Ngarkohet Drejtoria e Shoqerive Publike te ndjeke zbatimin e ketij urdheri.

Akti i themelimit, statuti i shoqerise, kerkesa per miratimin e eksperteve kontabel, kerkesa per rregjistrimin e shoqerise ne rregjistrin tregtar dhe aktet e tjera te nevojshme do te neshkruhen nga Drejtori i Drejtorise se Shoqerive Publike


MINISTRI
DYLBER VRIONI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E SHOQERIVE PUBLIKE

Nr. 14767 .Prot.

Tirane, me 3 .10.1995

K E R K E S E

PER

RREGJISTRIMIN E SHOQERISE TREGTARE
ANONIME
SI PERSON JURIDIK

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Ne baze te Ligjit Nr.7926 date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", kemi krijuar shoqerine anonime Sh.A "Furnizim Artikuj Farmaceutik" Tirane, me objekt veprimtarie; grumbulli, tregtim artikuj farmaceutik, me anetar te Keshillit Mbikqyres.

1. Petraq Cama
2. Ilir Zego
3. Ilia Samsuri

Ne baze te Ligjit Nr.7667, date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtare", kerkojme nga ana juaj rregjistrimin e shoqerise si person juridik.

DREJTORI I DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE

BERZH PIRANIAN

*Se regjistruar
Kuvendi
Sh. 6.10.1995
Sh. 1.10.1995
Sh. 1.10.1995*

Sh. 1.10.1995

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E SHOQERIVE PUBLIKE

Nr. 1467.Prot.

Tirane, me 3.10.1995.

K E R K E S E

PER
MIRATIMIN E EKSPERTEVE KONTABEL PER VLERESIMIN
E KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE
ANONIME

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Ne baze te ligjit 7926 date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" kemi vendosur transformimin e ndermarrjes "Furnizim Artikuj Farmaceutik" Tirane, ne shoqeri anonime.

Ne baze te Ligjit 7639, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", kerkojme miratimin nga ana e kesaj gjykate te eksperteve kontabel si me poshte :

1. Garrufa Noti

DREJTORI I DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE



BERZH PIRANIAN



Dega :
Nr. _____ Prot.
Lēnda :

1. Ministri Financave (Përfaq. Ilir Zego nr. 170025	po
2. Avdulla Huta	10513 po
3. Aferdita Dona	286 po
4. Agim Lame	125 po
5. Agim Rexha	78 po
6. Agim Guzi	52 jo
7. Agron Hibrihimi	52 po
8. Agron Plaku	52 jo
9. Arqile Naska	21 jo
10. Bardhyl Saraçi	1040 po
11. Bujar Demiri	94 po
12. Bujar Ciçi	68 jo
13. Dashamir Nanagjoka	125 jo
14. Dervish Shkoza	36 jo
15. Dhimiter Kikina	520 po
16. Dhimiter Trebicka	208 jo
17. Diana Tusha	120 jo
18. Dod Boçi	99 jo
19. Drita Luarasi	21 jo
20. Durim Kaderja	52 jo

a	b	c	d
21. Dyl	Imeri	78	jo
22. Edmond	Shpuza	78	po
23. Eleni	Milo	130	po
24. Engjell	Mehmeti	130	jo
25. Enver	Saraçi	1076	po
26. Erleni	Kurti	26	jo
27. Ermioni	Peshkateri	78	po
28. Ermira	Visoka	468	po
29. Esat	Pelivani	130	po
30. Fadil	Isufi	156	jo
31. Fatime	Myderizi	229	po
32. Fatmira	Tafalla	104	po
33. Fatos	Kadesha	135	po
34. Ferid	Sula	94	po
35. Fetah	Tafa	104	jo
36. Fezo	Muho	78	jo
37. Fitor	Hoxha	130	po
38. Genci	Zena	99	jo
39. Gëzim	Hyseni	78	po
40. Gëzim	Çela	52	po
41. Gjon	Kuçaj	16	jo
42. Hajrie	Vejsiu	94	po
43. Hamit	Balla	78	po
44. Ikbal	Vaidi	99	po
45. Ikbale	Bromati	94	po
46. Ilir	Radoniqi	88	jo
47. Irini	Lilaj	172	jo
48. Ismail	Babamusta	520	jo
49. Izet	Tafani	78	jo
50. Jani	Mio	78	jo
51. Jorgji	Qirjazi	312	po
52. Kamber	Alikaj	962	po
53. Katerina	Tase	78	jo
54. Kimete	Pepa	78	jo
55. Kolec	Daja	166	po
56. Koli	Bida	68	jo
57. Kujtim	Doda	416	po
58. Kushulle	Zhalli	1786	jo

a	b	c	d
59. Liljana	Klomo	120	po
60. Linda	Etehemaj	156	po
61. Liri	Jano	78	po
62. Luan	Zengla	1040	po
63. Luan	Leka	790	po
64. Luljeta	Bakllava	99	po
65. Lumturi	Brahaj	99	po
66. Luçije	Premalej	208	jo
67. Meliha	Xhaferri	140	po
68. Mentor	Zengla	1040	po
69. Meriban	Memi	192	po
70. Mersin	Rabdishti	21	jo
71. Mihallaq	Mihali	78	po
72. Mirjeta	Desoku "	36	jo
73. Mustafa	Serezi	3131	po
74. Mustafa	Noqi	104	jo
75. Myrvete	Pellumbi	99	po
76. Nadia	Haxhi	99	po
77. Naim	Kaba	416	jo
78. Namik	Kacidhja	120	jo
79. Narim	Sulçebe	239	jo
80. Nazif	Kasemi	78	po
81. Nebi	Gerbi	42	jo
82. Nevres	Xhudi	31	jo
83. Oresti	Graboska	104	jo
84. Pal	Gecaj	156	jo
85. Pavli	Kisi	62	jo
86. Pavlina	Angjeli	78	jo
87. Pellumb	Hidri	78	po
88. Petraq	Cano	120	po
89. Petrit	Pepa	21	jo
90. Petrit	Gazheli	33872	po
91. Pranvera	Rexha	198	po
92. Prenush	Kola	166	po
93. Rexhep	Topi	78	jo
94. Roland	Mertiri	120	po
95. Sadulla	Kerluku	1164	po



a	b	c	d
96. Sami	Milla	94	jo
97. Shkëqim	Leka	135	jo
98. Shpetim	Kalenja	832	po
99. Shpresa	Manopuli	83	jo
100. Shpresa	Hafizllari	109	jo
101. Shyqyri	Huta	52	jo
102. Skënder	Tomini	156	po
103. Sokol	Dedja	47	jo
104. Salandi	Broja	1559	jo
105. Suzana	Ferhati	47	jo
106. Suzana	Bifsha	78	jo
107. Suzana	Molla	52	jo
108. Terezina	Garku	121	jo
109. Teuta	Demiri	78	jo
110. Thoma	Nano	73	jo
111. Thoma	Tola	16	jo
112. Tonon	Gjoka	16	jo
113. Valter	Seferi	208	jo
114. Vasilika	Liço	78	po
115. Xhafer	Khako	364	po
116. Xhevdet	Muca	52	jo
117. Ymer	Oreshka	42	po
118. Zydi	Bona	728	jo

Përfundimisht nga Nr. i aksioneve rezulton pjesmarrje mbi 50 %.

1. Zgjedhja Kryetarit Asamblesë

Propozimet

Z. Petraq Cana propozon Kryetar

Z. Luan Leka

Propozimi u hodh në votë rezulton 70 %

2. Kryetari mori drejtimin e mbledhjes dhe fillojmë shqyrtimin e statutit.

Kryetari Asamblesë propozon që neni 1 i statutit të formulohet si me poshtë :

Paragrafi i nenit I mbetet

Paragrafi i nenit II formulohet

Shoqëria Anonime është shoqëri tregtare me pronesi pjesërisht shtetërore dhe pjesërisht private, si rezultat i privatizimit të një pjese të aksioneve të saj, sipas pjesëmarrjes në kapital të paleve të përcaktuar në nenin 4 të këtij Statuti.

Shoqëria është shoqëri anonome pa ofertë publike, përsa kohe që Asambleja e Aksionereve nuk do të marrë një vendim tjetër për shkrimin e saj në një formë tjetër të shoqërive tregtare të parashikuar në ligjin Nr.7638, dt. 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare. Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozita përkatëse të ligjit Nr.7638, dt.19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare nga statuti si dhe gjithë legjislacioni tjetër Shqiptar në fuqi.

Paragrafi 2 dhe 3 shfuqizohen të nenit (1)

Neni (1) u votua dhe u miratua me 80 % të aksionerve pjesëmarrëse.

Kryetari i asamblesë propozon nenin(2) statutit të ndryshëm si me poshtë :

(neni 2)

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj aktivitetin e importit eksportit, tregtimin mbrenda vendit të artikujve dhe paisjeve mjekësore dhe farmaceutike, si dhe çdo veprimtari tjetër financiare, tregtare industriale, etjera që lidhen dretpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së saj, o të tjera që janë të lidhura me gjithë pasurinë e shoqërisë. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të reja, krijimin e përmarrjeve të tjera dhe pjesëmarrjen në sipërmarrje si brenda

ashtu e jashtë vendit pa cenuar objektin e veprimtarisë shoqërore të
Shoqëria ka të drejta gjithashtu që brenda knadrit të
dispozitave ligjore, të marrë të gjitha masat dhe të kryejë çdo
biznes të përshtatshëm për arritjen e qëllimit të veprimtarisë
saj.

Diskutime I. Zeqo. I përgjigjet pyetjes së nenit 2
Po të shikojmë statutin e parë shikojmë që është grumbullim treg
i artikujve farmaceutikë duke e parë që është shumë i cunuar ne
shikojmë dhe shkruajmë një fushë më të gjërë veprimi farmaceutik
dhe paisjeve mjeksore, sepse objekti që ka qënë më parë ishte sh
i cunuar.

Skënderi. Duhet të shtohet dhe optike dhe Kozmetike.

Fatosi. Në pikën 2 themi që të shtohet e veprimtari
tjera farmaceutike.

Mustafai. Ka veprimtari nd/ja që lekët t'i kthejë në
valutë, por duhet të shtohet dhe kambizmi, prandaj aty duhet
shtohet edhe turizmi transporti. Në rast se unë do të shkojë në
kë dhe do të kthejë paratë s'të lë banka.

Iliri: Këto që thonë ju dalin jashtë objektit të kësaj
nd/jë Neni (2) u votua dhe u miratua me 80 % të aksioneve për
sëmarrëse.

Kryetari i asamblesë diskutoi që mbas nenit 2 të shtohet
neni 2/1 me këtë përmbajtje:

Selia (vendodhja e shoqërisë) do të jetë në qytetin
e Tiranës Adresa e saj është :

Rruga "Qemal Stafa "

Ajo mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda teri
torit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të thjeshtë të
Këshillit Mbikqyres, me kusht që ky vendim të miratohet nga mble
dhja me e afërt e Asamblesë së Aksionereve, si dhe çdo vend tjetër
jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendimin e Asam
së së Jashtëzakonshme të Aksionereve.

Ne rastine transferimit të selisë së shoqërisë me venci
min e Këshillit Mbikqyres, ky i fundit është i autorizuar të bë,

ndryshimet e nevojshme ne statutin e shoqerise.

Neni 3

Kryetari i asamblesë propozon që neni 3 të ndryshoje si me poshtë :

Kapitali themeltar i shoqërisë është 242.892.000 lekë.

Ai është i ndarë ne 242.892 aksione të së njejtës kate

I. Zeqo. I përgjigjet pyetjes së nenit 2
ri me vlerë nominale të aksionit 1000 lekë secili.
Po të shikojmë statutin e parë shikojmë që është grumbullim treg
i artikujve farmaceutikë dhe optikë dhe kozmetike.
shikojmë dhe shkruajmë një fushë më të gjërë veprimi farmaceutik
ndare si me poshtë :
dhe paisjeve mjekësore, sepse objekti që ka qënë më parë ishte sh
i cunuar.

Skënderi. Duhet të shtohet dhe optike dhe Kozmetike.
Fatosi. Në pikën 2 themi që të shtohet e veprimtari
Nr. 1 E m e r t i m i ! Nr. leke ! Nr. aksione ! Nr. ne
tjetera farmaceutike.

Mustafa. Ka veprimtari nd/ja që lekët t'i kthejë në
- Pronesia shtetërore 170.025.000 + 170.025 70
valute, por duhet të shtohet dhe kamorizmi, prandaj aty duhet
shprehur për vlerën e transportit 1.728.867.000 se unë do të shkojë në
kë dhe do të kthejë paratë s'të lë banka.
Nga kjo :

Iliri: Këto që thonë ju dalin jashtë objektit të kësaj
- Aksione të shitura 62.354.000 62.354 25,67

- Aksione të pronarit të
truallit 10.513.000 10.513 4.33

D i s k u t i m e t

Neni 3 u votua u miratua me 80 % të aksionerve pjesëmarrës

Neni 4

Kryetari i Asamblesë propozon qe neni 4 të ndryshojë.

Aksionet e shoqërisë që janë në zoterim të shtetit, mund të shiten personave fizike e juridike shqiptar vetëm me rastin e një vendimi të marrë nga Ministria e Financave për privatizimin e metejshëm të shoqërisë nëpërmjet bonave të privatizimit dhe lehtë të privatizimit, shitje që do të realizohet jashtë shoqërisë.

Personat e huaj fizik e juridik, mund të blejnë aksione të shoqërisë vetëm në rastet dhe në masën e caktuar nga Ministria e Financave. Shlyerja e aksioneve nga personat e huaj fizik e juridik bëhet vetëm me para ose me anën e kontributeve në natyrë për qëllime teknologjike.

Diskutimet e propozimet

Diskutime nuk pati.

Ndryshimi i nenit 4 u votua u miratua me 80 % të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari i asamblesë propozon të shtohet neni 4!1 ndryshim e kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të ndryshohet (zmadhohet ose zvogëlohet në të gjitha format dhe sipas modaliteteve të parashikua në ligjin 7638 dt.19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare " Në të gjitha rastet i vetmi organ kompetent për të vendosur ose autorizuar ndryshimet e kapitalit themeltar është mbledhja e jashtëzakonësh e Aksionerëve, mbi bazën e raportit të drejtorisë ose të ekspertve kontabel.

Zmadhimi i kapitalit themeltar

Në përputhje me ligjin e aksionerët kanë përpjestimisht me shumën e aksioneve të tyre, një të drejtë parësore me nënshkr

min e aksioneve të para, të emërtuara për të kryer një zmadhim të kapitalit. Ato mund të heqin dore nga kjo e drejtë vetëm individualisht.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

Në të gjitha rastet e zvogëlimit të kapitalit themeltar ky zvogëlim do të prekë në të njëjtën masë në përpjestim me vlerë e aksioneve që ata zotërojnë.

Zvogëlimi i kapitalit, për çfarëdo shkakut qoftë në një shumë më të vogël se minimumi ligjor mund të vendoset vetëm me kushtin pezullues të një zmadhimi të kapitalit i destinuar të çojë këtë të fundit të paktën në minimumin ligjor, përveç rastit kur shoqëria transformohet në një shoqëri të një forme tjetër që nuk kërkon një kapital me të lartë se sa ai i zvogëluar.

Në rastin e mos respektimit të kësaj dispozite çdo interesuar mund të kërkojë nga gjykata kompetente prishjen e shoqërisë. Prishja e shoqërisë nuk mund të shpallet nëse ditën kur gjykata shqyrton çështjen gjëndja është rregulluar.

Diskutimet nuk pati

Neni 4/1 u votua u miratua mbi 80 % e votave të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari i asamblesë propozon të shtohet neni 4/2.

Aksionet janë të formes emërore.

Pronesia e aksioneve rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit ose të titullarëve në librin e aksioneve të majtura nga ana e shoqërisë.

Libri i aksioneve do të përmbajë në çdo kohë informatat që vijnë, numri dhe kategorinë e aksioneve, datën e marrjes, nga aksioneri si dhe vlera nominale për çdo aksion të zotëruar.



Sejcili aksioner ka të drejtë të kërkojë me shkrim dhe marrë një nxjerrje (ekstrat) nga libri i aksionerëve , i cili vë tetohet me volën e shoqërisë.

Sejcili aksioner ka të drejtë të verifikojë në se emri i tij është futur në librin e aksionistëve dhe personi, i cili mban librin e aksionistëve është i detyruar t'i tregojë aksioner me kërkesën e këtij të fundit, hyrjen përkatëse në libër.

Diskutimet Nuk pati.

Neni 4/2 u votua u miratua mbi 80 % e votave të aksionerëve pjesëmarrëse.

Kryetari i asamblesë propozon shtimin e nenit 4/3. Shitje dhe transferimi i aksioneve

Aksionet janë lirisht të transferueshme, pa miratimin e shoqërisë. Në rastin e zmadhimit të kapitalit, aksionet janë lirisht të tregtueshme pas realizimit të këtij zmadhimi. Pas prishjes (likuidimit) të shoqërisë aksionet mbeten lirisht të tregtueshme dhe në mbylljen e likuidimit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ndryshimi i pronësisë së aksioneve si rrjedhojë e një shitjeje apo e një transferimi, kryhen nëpërmjet një kalimi nga llogaria e dhënësit tek llogaria e marrësit në bazë të një urdhëri xhirimi.

Shoqëria është e detyruar të kryejë këtë regjistrim dhe të ketë xhirim brenda 6 (gjashtë) ditëve nga marrja e urdhërit xhirimi.

Urdhëri xhirimi i përgatitur në një formular të dhënë nga shoqëria ose të miratuar nga shoqëria nënshkruhet nga dhënësi i aksionit ose përfaqësuesi i tij. Nëse aksionet nuk janë shlyer t

për marrjen në dorëzim të adresuar te titullari i aksioneve

Çdo vonesë në derdhjen e shumave të dukura nga shuma pa shlyera të aksioneve sjell pagimin e interesave me % 11 dhe kjo pavarësisht nga veprimi personal që shoqëria mund të troje nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga lacioni në fuqi për këtë problem.

Diskutimet nuk pati

Neni 4 (u votua dhe u miratua mbi 80 % e votave të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari i Asamblesë propozon që të shtohet kapitulli II me nenin 4/5.

Aksionerët e shoqërisë

Aksionerët e shoqërisë janë persona fizikë dhe juridikë që kanë vënë ose do të vënë në zotërim aksione të shoqërisë gjitha mënyrat e parashikuara nga ligji.

Pronesia mbi aksionet e shoqërisë përmban aderimin të drejta të plota në statutin e shoqërisë nëpërmjet përfaqësuesve në asamblenë e përgjithshme të aksionistëve.

Diskutimet nuk pati.

Neni 4/5 u votua u miratua mbi 85 % e votave të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari i Asamblesë propozon shtimin e nenit 4/6

Të drejtat dhe detyrat e Aksionerëve

Çdo Aksioner i shoqërisë ka të drejtën e pjesëmarrjes

rësisht, urdhër rihirimi nënshkruhet edhe nga marrësi.

Shoqëria do të kërkojë që nënshkrimet e palëve të ver-
tetojnë nga përveç rasteve nga ky vërtetim është përjashtuar nga
gji.

Transferimi i aksioneve falas si rrjedhojë e trashigim-
së kryhet gjithashtu me anë të kalimit në llogari në bazë të nje
dokumenti ligjor që vërteton transferimin.

Shpenzimet për transferimin e aksioneve janë në ngarkim
të marrësit, përveç rastit të nje marrëveshjeje të madhe e midis
dhënësit, marrësit.

Aksionet e pashlyera për derdhjet e kërkuara nuk mund
pranohen për transferim.

Diskutime nuk ka.

Neni 4/3 u votua u miratua mbi 80 % e votave të aksio-
neve pjesëmarrëse.

Kryetari i asamblesë propozon shtimin e nenit 4/4.

Shlyerja e aksioneve.

Aksionet e nënshkruara më para lidhur me zmadhimin e
kapitalit të shoqërisë duhet të shqyrtojnë sipas modaliteteve të
caktuara nga asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme. Shlyerja
këtyre aksioneve nuk mund të jetë më e ulët se sa një e katërta e
vlerës nominale dhe nëse është rasti e teresisë së primeve të emi-
sionit. Shlyerja e vlerës nominale të mbetur duhet të kryhet në n-
ose dësa këste me kërkesë të drejtorisë së Përgjithshme të Shoqëri-
në një afat prej 2 (dy) vjetësh nga data kur ky zmadhim i kapitalit
është bërë përfundimtar.

Kërkesat e fondeve për shlyerjen e aksioneve u bëhen të
njohura nënshkruesve të pakten 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara dat-
së caktuar për çdo derdhje, me letër rekomande me kthim përgjigje

në fitimet e shpërndashme të shoqërisë në përputhje me aksionin e tij sipas vlerës nominale të zotëruar prej tij në kapitalin themelues të shoqërisë.

Çdo aksionist ka të drejtë të marrë kur është rastë një pjesë nga teprica e likuidimit të shoqërisë në të njëjtin përpjesëtim sipas paragrafit të parë të këtij neni.

Aksionerët kanë të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në asamblenë e përgjithshme të aksioneve në kushtet e parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe nga ky statut.

Aksionerët janë vetë përgjegjës për detyrimet dhe për humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës nominale të aksioneve që zotërojnë, kërkimin e fondeve të kësaj mase është i ndaluar.

Të drejtat dhe detyrimet e përmendura me sipër ndjekin aksionin në çfarëdo forme që ai tjetërsohet tek të tretët.

Publikimi i lajmërimit duhet të bëhet të paktën 15 (peshmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë.

Në rast të veçanta çohet me letër rekomande.

Mbledhja e Asamblesë së zakonshme bëhet në zyrat ku ka selinë shoqëria ose në një vend tjetër, që mund të vendosë këshillmbikqyres ose drejtoria.

Diskutimet nuk pati

Neni 4/6 u votua u miratua mbi 85 % e votave të aksionpjesëmarëse.

Kryetari i Asamblesë propozon ndryshimin e nenit 5

Neni 5

Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

1. Asambleja e jashtëzakonshme dhe e zakonshme e aksioneve :

2. Këshilli mbikqyres

3. Drejtoria

Diskutimet nuk pati

Ndryshimet e nenit 5 u votua u miratua mbi 80 % të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari Asamblesë propozon shtimin e nenit 5/1.

Asambleja jashtëzakonshme e Aksioneve.

Asambleja e jashtëzakonshme e aksioneve ka kompetencë të miratojë statutin e shoqërisë ose të ndryshojë atë me të gjitha dispozitat e tij.

Asambleja e jashtëzakonshme merr vendime të vlefshme në përputhje me dispozitat e nenit 128 të ligjit Nr. 7638 dt.19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare ".

Diskutimet nuk pati

Neni 5/1 u votua, u miratua mbi 80 % e votave të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari Asamblesë propozon shtimin e nenit 5/2.

Asambleja e zakonshme e aksioneve.

Asambleja e zakonshme merr të gjitha vendimet përveç asnjëre që janë përcaktuar në ligj dhe në nenin 13 të këtij Statuti.

Asambleja e zakonshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar.

Mbledhja e asamblesë thirret nga Këshilli mbikqyres ose drejtoria, si dhe sipas rasteve të tjera të përcaktuara në ligjin

" Për shoqëritë tregtare."

Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Aksionereve përbëhet nëpërmjet lajmërimit që botohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore, i cili duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm siç janë dita, ora dhe vendi, natyra e mbledhjes dhe rendi i ditës.

Publikimi i lajmërimit duhet të bëhet të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë.

Me raste të veçanta bëhet me letër rekomande.

Mbledhja e Asamblesë së zakonshme bëhet në zyrat ku ka selinë shoqëria, ose në një vend tjetër që mund të vendosë Këshilli Mbikqyres ose Drejtoria.

Diskutime nuk pati

Neni 5/2 u votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari Asamblesë propozon shtimin e nenit 5/3?

Neni 5/3

Çdo aksion me vlerë nominale 1000 lekë përfaqëson vetëm një vote.

E Drejta e votes rrjedh nga zotërimi i aksioneve dhe është proporcional me pjesën e kapitalit që ato përfaqësojnë.

E drejta e votes mund të ushtrohet me anë të një autorizimi për të cilin kërkohet një formë e shkruar.

Kushtet në bazë të të cilave aksionmbajtësit mund të ushtrojnë të drejtën e votes në asamble, përcaktohen me ftesën për të marrë pjesë në Asamblenë e aksionmbajtësve për atë kohë sa nuk janë Certifikatat e aksioneve.

Diskutimet

Neni 5/3 u votua, u miratua mbi 80 % të votave të aksioneve pjesëmarëse.

Kryetari i Asamblesë propozon shtimin e nenit 5/4

Neni 5/4

Mbledhja e Asamblesë drejtohet nga kryetari i cili zgjidhet ananimisht nga Asamblea. Në rast se një gjë e tillë nuk arrihet atëherë si kryetar i Asamblesë do të jetë Kryetari i Këshillit të Mbikqyres. Asambleja zgjedh edhe një sekretar.

Kryetari drejton Asamblenë dhe vendos mbi vazhdimsinë, objektet e bisedimit dhe mbi mënyrën e votimit.

Diskutime nuk pati

Neni 5/4 u votua u miratua me 81 % të votave të aksioneve pjesëmarëse.

Kryetari i Asamblesë propozon shtimin e nenit 5/5

Neni 5/5

Asambleja merr vendimetë vlefshme në mbledhjen e parë vetëm në qoftëse aksioneret e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë në të paktën 1/4 e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se ky përfaqësim nuk realizohet, në mbledhjen e dytë nuk kërkohet asnjë sqarim.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksioneret e pranishëm ose të përfaqësuar.

Rezultati i votes mund të përcaktohet me anë të metodës së zbritjes së votave "po" ose "jo" dhe abstenimit të votave të aksionerëve mbajtësve të lejuara në total.

Diskutime. nuk pati

Neni 5/5 u votua, u miratua me 80 % të votave të aksioneve

neve pjesëmarrëse.

Kryetari i Asamblesë propozon shtimin e nenit 5/6.

Në asamblenë e aksionmbajtësve do të meren aktet noteriale të cilat do të firmosen nga noteri dhe kryetari i Asamblesë.

Diskutime nuk pati

Neni 5/6 u votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari Asamblesë propozon shtimin e nenit 5/7.

Asambleja merr shqyrtimin bilancet e fundit të vitit raportin e Këshillit Mbikqyres, raportin e ekspertëve kontabel si dhe çështje të tjera financiare të vitit të kaluar, për të cilat merr vendimet përkatëse. I gjithë dokumentacioni i nevojshëm duhet të paraqitet asamblesë jo me vone se 15 ditë përpara datës së mbledhjes, në selinë e shoqërisë për të shqyrtuar nga aksionmbajtësit ose t'u dërgohen atyre në bazë të kërkesës së tyre.

Asambleja e zakonshme e mëron anëtarët e këshillit mbikqyres në përputhje me nenet 105 dhe 108 të ligjit për shoqëritë tregëtare si dhe shpërblimin vjetor të tyre.

Asambleja vendos për përdorimin e fitimit të vitit të kaluar si dhe për shpërndarjen e devidentit.

Diskutime nuk pati

Neni 5/7 u votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari i Asamblesë propozon ndryshimin e nenit 6.

Këshilli Mbikqyres

Këshilli Mbikqyres përbëhet nga tre anëtare. Emërimi i anëtareve të Këshillit Mbikqyres bëhet nga Asambleja e zakonshme e Aksionereve, 2 anëtare të Këshillit Mbikqyres propozohen nga aksioneri kryesor që ka mazhorancën absolute të aksioneve, ndërsa një

anëtar propozohet nga pjesa e tjetër e aksionerëve.

Asnje anëtar i këshillit mbikqyres nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i drejtorisë.

Diskutime nuk pati

Neni 6 u votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari i Asamblesë propozon shtimin e nenit 6/1.

Koha e ushtrimit të detyrës për Anëtar të këshillit të mbikqyrjes është 4 vjet. Agataret e Këshillit Mbikqyres mund të japin doreheqjen nga detyra me anë të një deklarate me shkrim e cila duhet t'i dërgohet kryetarit të këshillit mbikqyres duke respektuar një limit prej dy javësh. Anetaret e Këshillit mbikqyres janë persona fizikë. Ata nuk mund të jenë punësuar në shoqëri.

Diskutime nuk pati

Neni 6/1 u votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari i Asamblesë propozon ndryshimet e nenit 7.

Kryetari dhe zëvendës kryetari i këshillit të mbikqyrjes janë persona fizikë dhe nuk mund të zgjidhen ndërmjet përfaqësuesve të personave juridikë, për ndryshe emërimi i tyre është i pavlefshëm. Diskutime. Nuk pati

Neni 7 u votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrësve.

Kryetari i Asamblesë propozon ndryshimin e nenit 8.

Kompetencat e Këshillit Mbikqyres.



Këshilli i mbikqyrjes ushtron kontroll të vazhdueshëm ndaj drejtorisë për administrimin e shoqërisë nga ana e saj. Këshilli mbikqyrjes i jep autorizim paraprak drejtorisë për realizimin e gjithë operacioneve të parashikuara në statut.

Këshilli i mbikqyrjes mund të përcaktojë një listë të atyre masave dhe veprimeve të cilat duhet të merren nga drejtoria e shoqërisë këto i nënshtrohen marrëveshjes fillestare të këshillit mbikqyrjes. Kjo është e vlefshme veçanërisht për politikën e objektivit të biznesit, Investimeve, financimit, fushave të veprimit të shoqërisë dhe personelit dhe drejtimit të kontratave.

Këshilli mbikqyrjes ka të drejtë të kryejë në kohë verifikime dhe kontrole që ai çmon të përshtatshme dhe kërkon të njihet me dokumentat që ai gjykon të nevojshme për mbushjen e detyrës së tij.

Këshilli i mbikqyrjes mund të kërkojë nga drejtoria një raport për problemet e shoqërisë, marrëdhëniet ligjore dhe të biznesit me shoqërinë që ka lidhje si dhe me aktivitetet e biznesit që janë sinjifikative për pozicionin e aksionerëve.

Këshilli i mbikqyrjes shqyrton dhe verifikon rezultate financiare të mbylljes së vitit ushtrimor dhe llogaritë vjetore, cilat duhet t'i paraqiten atij nga drejtoria brenda 3/muajve nga data e mbylljes së vitit.

Diskutimet nuk pati

Neni 8 u votua u miratua me 80 % të votave të aksionerëve pjesëmarrës.

Kryetari i Adamblesë propozon shtimin e nenit 8/1.

Çdo anëtar i këshillit mbikqyrjes, përveç kompesimit për shpenzimet e tij, do të marrë një shpërblim vjetor në masën 20 % të pages së drejtorit. Masa e shpërblimit për kryetarin dhe

zëvendës kryetarin miratohen nga këshilli i mbikqyrjes, por jo me shumë se 30 dhe 25 % respektivisht të pages së drejtorit, e cila do të jepet muaj.

Diskutime S'ka.

Neni 8/1 u votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari i Asamblesë propozon shtimin e nenit 8/2.

Anëtarët e Këshillit mbikqyres duhet të ruajnë mënyrën e gjykimit dhe të veprimit në lidhje me informacionin konfidencial dhe se kutet e shoqërisë, veçanërisht e të biznesit për të cilat ato janë bërë të vetëdijshëm nëpërmjet punës së tyre, kjo mbetet e vlefshme edhe pas largimit nga këshilli mbikqyres.

Informacion lidhur me shoqërinë mund t'i transferohet lëve të treta vetëm me miratimin e kryetarit të këshillit mbikqyres dhe me kusht që transferimi nuk rezikon interesat e shoqërisë.

Nuk pati diskutime.

Neni 8/2 u votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari i Asamblesë propozon ndryshimin e nenit 9

Vendimet e këshillit

Këshilli mbikqyres mbledhet sa herë që e kërkon interesi i shoqërisë, me thirrjen e kryetarit, ose në mungesën e tij, zëvendës kryetarit.

Kryetari duhet të thërrasë këshillin mbikqyres brenda 15 ditëve kur drejtori ose një e treta e anëtarëve të këshillit mbikqyres i paraqitur atij nje kërkesë të motivuar për këtë qëllim.

Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëhere autoret e kërkesës mund të thërrasin këshillin, duke i përmendur rendin e ditës.

Në parim thirrja duhet të bëhet tre ditë përpara, me letër, telegram ose telefax. Por ajo mund të bëhet me gojë dhe pafat n.q. se anëtarët e Këshillit mbikqyres e pranojnë atë.

Çdo thirrje duhet të tregojë qështjen kryesore të rendit të ditës.

Mbledhja e këshillit mbikqyres bëhet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje.

II. Këshilli mbikqyres mund të marrë një vendim të vlerësueshëm në qoftëse janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të këshillit.

Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast votash të barabardhtë, ajo e kryetarit është e përfaktuese.

III. Këshilli mbikqyres mban rregjistër të pjesëmarrjes në mbledhjen e tij, i cili nënshkruhet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

IV. Vendimet e këshillit mbikqyres evidentohen me proces verbale të hartuara në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi nga kryetari i seances dhe nga një anëtar i këshillit ose në muajt të kryetarit dhe nga jo më pak se dy anëtarë të këshillit.

Kopjet e këtyre proces verbaleve vërtetohen nga kryetari i këshillit mbikqyres zëvendës kryetar dhe nga drejtori i përgjithshëm.

Diskutime nuk pati

Neni 9 u votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrësve.

Kryetari i Asamblesë propozon që neni 10 të shfuqizohet.

Diskutime nuk pati.

U votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrësve.

Kryetari i Asamblesë propozon ndryshimin e nenit 11

Drejtoria

Drejtoria përbëhet nga një person që është drejtor

Drejtoria mund të përbëhet edhe nga disa persona numri i të cilëve përcaktohet nga Këshilli mbikqyres.

U votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesë marëse.

Kryetari i Asamblesë propozon shtimin e nenit 11/1.

Drejtori i Përgjithshëm

I. Drejtori i përgjithshëm e mërohet nga këshilli mbikqyres kur për të janë dakort jo me pak se 3/4 e anëtarëve të këtij këshilli, ai mund të zgjidhet qoftë ndërmjet personave të shoqërisë qoftë edhe jashtë të punësuarve të saj.

Drejtori mund të shkarkohet nga këshilli mbikqyres vetëm për shkaqe të përligjura. Në rastin kur i interesuara ka lidhur kontratë punësimi me shoqërinë shkarkimi i tij nga funksioni i drejtorit nuk është shkak për zgjidhjen e kësaj kontrate.

II. Në rastet e pushimeve dhe të mungesave të tjera të zgjatura këshilli mbikqyres bën menjëherë zëvendësimin e tij.

Drejtori është i riemërueshëm.

Mënyra dhe masa e shpërblimit të drejtorit caktohet nga këshilli mbikqyres në aktin e emërimit të tij.

Diskutime nuk pati.

U votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesë marëse.

Kryetari i asamblesë propozon ndryshimin e nenit 12.

Kompetencat e drejtorit

Drejtori ka kompetenca të plota ndaj të tretëve, për të vepruar me emër të shoqërisë në çfarëdo rrethane me përjashtim të kompetencave që i kanë caktuar asamblesja e përgjithshme e këshillit mbikqyres nga ky statut.

Në marrëdhëniet me të tretët shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e drejtorit.

Nga ana ligjore shoqëria përfaqësohet nga drejtori i

përgjithshëm.

Megjithatë, në cilësinë e masave të rregullimeve të brendshme të shoqërisë, por që nuk i kundërvihet të tretëve, veprimit dhe masat e mëposhtëme, kryhen vetëm me autorizimin të asamblesë përgjithshme të këshillit mbikqyres.

Përcaktimi dhe ndryshimi i programit të veprimtarisë afatshkurtër, afat mesme dhe afat gjatë të shoqërisë.

- Kryerja e investimeve dhe financimeve për vitin financiar si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e buxhetit fillestar të shoqërisë.

- Hapja e veprimtarive ose njësive të reja shkrirja ose bashkimi dhe mbyllja tërësisht e pjesëshme e veprimtarive dhe njësive të shoqërisë, që përbëjnë

- Blerja, shkembimi dhe shitja e pasurive që përbëjnë aktivitetin e qëndrueshëm të shoqërisë në shoqëri

- Themelimi i shoqërive në pjesëmarrje të tjera të krijuara ose për tu krijuar.

- Marrja e huave afat mesme, afat gjatë, dhënia e ose garancive të tjera kur këto të fundit tejkalojnë veprimtaritë e zakonshme të shoqërisë.

- Ngacimi, përfundimi a ndryshimi i çdo kontrate me afat mbi 3 vjet për një shumë, detyrimesh vjetore mbi 2 milion lekë.

- Përcaktimi i kriterëve për diskutimin, përfundimin dhe ndryshimin e kontratës si punësimit me punonjësit.

- Në përgjithësi marrja e vendimeve dhe masave që e kapërcëjnë veprimtarinë e zakonshme të shoqërisë dhe që janë të tilla që mund të sjellin ndryshim në objektin e shoqërisë.

II. Drejtori i përgjithshëm mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij, që ai i gjykon të dobishme tek një ose dis persona të tjerë që kryejnë në funksione teknike në drejtimin e

shoqërisë.

III. Drejtori i përgjithshëm përfaqëson shoqërinë me marrëdhënie me të tretët të publikohet.

- Emërtimi dhe pushimi i tij duhet të publikohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

- Aktet, me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të mbajnë nënshkrimin e drejtorit të përgjithshëm ose të personit të autorizuar rregullisht nga drejtori për këto akte.

Eështë e detyrueshme që çdo marrëdhënie ndërmjet drejtorit të përgjithshëm dhe këshillit mbikqyres të regjistrohet ose të pasqyrohet në proces verbal.

Marëdhëniet brenda shoqërive përcaktohen me rregullore veçantë të cilat miratohen me këshillat mbikqyres të këtyre shoqërive.

Diskutime nuk pati

U votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari porozon që neni 13 shfuqizohet.

Kryetari i Asamblesë propozon ndryshimin e nenit 14

Kontrolli ushtrohet nga eksperte kontabel të liçensuar të cilët emërohen nga asambjeja aksionmbajtësve.

Nga diskutimet doli që të jenë 2 ekspertë kontabel.

U votua u miratua me 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse.

Kryetari i Asamblesë propozon ndryshimin e nenit 15

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të vitit.

Kryetari propozon që neni 16 nuk ndryshon.

Shoqëria do të mbaj një kontavilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj, në pajtim me kërkesat ligjore

Në mbyllje të ushtrimit, drejtori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar.

Drejtori përgatit gjithashtu dhe raportin e administrimit për gjëndjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara për të ardhmen, ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës nga data e mbylljes së ushtrimit financiar deri në datë e hartimit të këtij raporti.

Kryetari i Asamblesë propozon nenet I7,I8,I9 të shfiqizohen Diskutime nuk pati.

U votua u miratua me 80% të votave të aksioneve pjesmarrëse.

Kryetari i Asamblesë propozon shtimin e nenit I9/I

Përsa nuk bëhet fjalë në këtë statut i referohet zgjidhjeve të ligjit Nr. 7638 dt. 19.II.1992 " Për shoqëritë Tregtare".

Diskutime nuk, pati.

U votua u miratua me 80% të votave të aksioneve pjesmarrëse

Kryetari i Asamblesë vazhdon mbledhjen me shtrimin e kërkesë që ka bërë i z. tokës (truallit) në bazë të vendimit të komisionit të kthimit të proneve Nr. 8II dt. 15.03.1996 t'i kthehen 279I m2 që është e lirë në ndërmarrjen Fu-Farma Tiranë.

Diskutime.

Ilir Zeqo. Zvogëlimi i kapitalit vendoset në mbledhjen e j tëzacakshme të Asamblesë.

Mustafa Serezi. Sot në mbledhjen e jashtëzakonshme të asalesë nuk bëhet zvogëlimi i kapitalit, por 2-3 muaj përpara.

Këtë problem t'ja lëmë këshillit mbikqyrës, juristes ta diskutojnë në bazë të ligjeve të shtetit. Një pronë nuk shitet dy herë.

Petrit Gazheli. Një pronë nuk shitet dy herë. do të shkoj do të interesohem për këtë problem.

Jorgji. Nuk është dakort t'i kthehet toka pronarit.

Mustafa. Më dt. 3I.OI.96 ja shiti aksionerëve më dt. 15.096 ja kthen pronarit atëhere si t'ja bëjmë.

Propozimi u hodh në votë dhe u miratua ~~80%~~ me 80% të aksioneve pjesmarrëse që toka e lirë prej 279I m2 t'i kthehet pronarit.

Nuk ishin dakort z. Petrit Gazheli, M. Serezi, Jorgji.

Kryetari i asamblesë vazhdon mbledhjen me zgjedhjen e Këshillit mbikqyrës. U propozua që ~~Këshilli~~ Këshilli Mbikqyrës të përbëhet nga 3 vet

Propozimi u hodh në votë dhe u miratua 80% që K. Mbikqyrës të jetë me tre veta.

Propozimet janë :

1. Petrit Gazheli
2. Ilir Zeqo
3. Petraq Cama

Kryetari i Asamblesë filloi votimin për emrat e pro-
pozuar.

1. Lir Zeqo 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse
2. Petraq Cama 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse.
3. Petrit Gazheli 80 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse.

K R Y E T A R I

(Signature)
Lir Zeqo

S E K R E T A R I

(Signature)
Ilir Zeqo

Tiranë, me 8.7. 1996

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
N O T E R I A

VËRTETIM

Nr. 6379 rep. — Kol

Vërtetohet se sot më dt 18.7.1996, unë noterja e njohur publike në Tiranë, Violeta Frashëri, mora pjesë në mbledhjen e themelimit të Shoqërisë Aksionere FUFARMA Tiranë me 70% kapital shtetëror dhe 30% kapital privat dhe asistova në mbajtjen e proces-verbalit të mbledhjes të kësaj shoqërie, si dhe vërtetoj përmbajtjen e plotë të këtij proces-verbali, si dhe çfarë u vendos në atë mbledhje, si dhe vërtetoj edhe nënshkrimin dhe prezencën e kryetarit z. Luan Leka dhe të sekretares z. Afërdita Dako, të dy madhorë dhe me zotësi të plotë për të vepruar, konform ligjeve në fuqi.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NOTERIA TIRANË Nr. 6379


18.12.1996

Vërtetohet me origjinal

NOTERE
VIOLETA FRASHËRI *(Signature)*

Notere

Violeta Frashëri



REPUBLIKA E SHQIPERISE

SH.A. FU-FARMA

Asambleja Aksionereve

Vendim Nr.2

Për emërimin e anëtareve të këshillit mbikqyres

Asambleja e mbledhur me dt.08.07.1996

SH. A. FU- FARMA

V E N D O S I ,

1. Këshilli të përbëhet nga 3 anëtarë

2. Anëtarët janë

- | | | | |
|----|---------------|----------------|--|
| 1. | <u>Petra</u> | <u>Qama</u> | 80 % të votave të aksioneve
pjesëmarrëse. |
| 2. | <u>Ilir</u> | <u>Zeqo</u> | —" |
| 3. | <u>Petrit</u> | <u>Gazheli</u> | —" |

3. Paga dhe shpërblimi i tyre sipas dispozitave të
statutit të fillojë nga data _____.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

(Dhimitër Lami)

Dhimitër Lami

S E K R E T A R I

Agim Durrës

Agim Durrës

Tiranë me, 10 Shtator 1996

V E N D I M .

Këshilli mbikëqyres i shoqëris anonime Fu farma Tiranë në mbledhjen e tij të datës 10.09.1996 vendosi:

- 1- Zoti Kolec Daja të riemrohet drejtor i shoqëris anonime Fufarma .

Keshilli mbikëqyres i shoqëris anonime Fufarma Tiranë.

Kryetari	N/kryetari	Antarë
Petraç Cama	Petrit Gosheli	Alir Zeqo.

